



BASHKIA BERAT

**PROJEKT BUXHETI I BASHKISE BERAT
PER VITIT 2019
&
PBA PERFUNDIMTARE 2019-2021**



BASHKIA BERAT

Permbajtja e Plan Buxhetit 2019 dhe PBA Perfundimtare 2019-2021

1. Mesazhi i kryetarit të Bashkise Berat Z. Petrit SINAJ

1.1 Hyrje.

1.2 Objektivat e P/buxhetit të bashkise Berat për vitin 2019.

1.3 Informacion përmbledhës për P/ buxhetin e vitit 2019 .

2. Financimet e Bashkise Berat për vitin 2019 dhe periudhën afatmesme 2019-2021

2.1 Plan i financiar i periudhës afatmesme 2019-2021.

2.2 Transferta e pakushtëzuar 2019.

2.3. Transferta sektoriale 2019.

2.4. Transferta të Kushtëzuara për funksione të deleguara.

2.5 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

2.6. Planifikimi i Të ardhurave nga taksat & tarifave vendore për vitin 2019 dhe PBA 2019-2021

2.7 Planifikimi i të ardhurave nga Institucionet e Varësisë për vitin 2019 dhe PBA 2019-2021.

3. Parashikimi i shpenzimeve të Bashkise Berat për vitin 2019

3.1 Stuktura Financiare e Buxhetit 2019.

3.2 Planifikimi shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike

3.2 A. Planifikimi I Shpenzimeve korrente

A 1. Planifikimi i nr.te punonjësve dhe shpenzimeve të personelit

A 2. Planifikimi paga dhe sigurime shoqërore).

A 3. Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike.

A 4. Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja.

A 5 . Shpenzimet për subvencione.

A 6 Transferta tek organizatat dhe individë.

A 7. Fondi rezervë, Fondi i kontigjencës, fondit i emergjencave civile.

3.2. B Planifikimi i shpenzimeve kapitale (fondi i investimeve)

4. Planifikimi i shpenzimeve sipas programeve dhe përkrahjet e tyre.

5. Planifikimi i shpenzimeve sipas njësive shpenzuese.

5.1 Bashkia Berat



BASHKIA BERAT

5. 2 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
 5. 3 Ndërmarrja e Gjelberimit.
 5. 4. Drejtoria e Bujqesise, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave dhe Sherbimit Veterinar.
 5. 5 Drejtoria Arsimore .
 5. 6 Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” .
 5. 7 Qendra “Lira”.
 5. 8 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mmbojtja civile.
-
6. Pasqyrat analitike te planifikimit te te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore per Bashkine dhe Njesite Administrative .
-
7. Planifikimi i te ardhurave nga drejtorite dhe institucionet e bashkise.
-
8. Pasqyrat analitike te shpenzimeve sipas njesive shpenzuese dhe sipas programeve buxhetore



BASHKIA BERAT

MESAZHI I KRYETARIT TE BASHKISE BERAT PER BUXHETIN E VITIT 2019 Z.PETRIT SINAJ

E nderuar znj. Nikoleta Manka, Kryetare e Keshillit te Bashkise Berat!

Te nderuar keshilltare!

Bashkeqytetare te mi,

Berati, qyteti mbi 2400 - vjeçar, që flet me historinë, me kulturën e vetë dhe që tashmë pret mijëra e mijëra turistë nga e gjithë bota, kërkon dhe meriton gjithë vëmendjen e pushtetit vendor dhe qendror.

Duke pasur ne qender te vëmendjes interesin publik, jemi perpjekur te planifikojme ne kete projektbuxhet fondet e nevojshme per te nxitur zhvillimin ekonomik nepermjet investimeve publike.

Buxheti i vitit 2019 dhe PBA perfundimtare 2019 - 2021 tregojne burimet e te ardhurave si dhe menyren e shpenzimeve te fondeve.

Buxheti 2019 është një dokument i rëndësishëm që përcakton drejtimit kryesore të zhvillimit të qytetit tonë bazuar në disa dokumente strategjike të hartuara nga Bashkia Berat, si:

1. Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkise,
2. Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit,
3. Strategjitë sektoriale (planet sektoriale) qe janë te lidhura me kompetencat e pushtetit vendor.

Thellimi i decentralizmit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore të qeverisë në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të shërbimeve, pamedyshje qe do te udheheqin gjithë veprimtarine tone te perditshme.

Viti 2019 do të jetë viti i implementimit të plotë të të gjithë instrumenteve të reja të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore duke konsoliduar burimet e financimit dhe sigurojnë një menaxhim më cilësor të shpenzimeve.

Në buxhetin afatmesem te Bashkise jane prioritizuar projektet sipas matricave te fish-projekteve te percaktuara ne Planet Strategjike, te cilat udheheqin çdo zhvillim ne qytet.

Duke qenë se qyteti i Beratit ka një strategji zhvillimi të orientuar kryesisht tek turizmi historik, kulturor dhe zhvillimi i agobiznesit, prioritet për ne kanë qenë projektet e fokusuara te rijetëzimi i



BASHKIA BERAT

trashëgimisë kulturore, kombinuar me agroturizmin dhe turizmin e aventurës, duke kombinuar trashëgiminë kulturore që ofron Qendra Historike me resurset natyrore të Parkut të Tomorit, zonës së Shpiragut dhe peizazhit natyror që ofron tashme territori i ri i Bashkisë.

Trashëgimia kulturore e Beratit si Sit në UNESCO e ka kthyer Beratin në një destinacion ndërkombëtar të turizmit kulturor, duke ofruar një eksperiencë të paharrueshme për vizitorët e pasionuar pas kulturës, historisë, artit dhe natyrës.

Gjatë vitit 2018 Berati u vizitua nga rreth 150 mijë turistë, shifer kjo rreth 50% më e lartë karasuar me vitin 2017.

Tashmë me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim jemi drejt financimit të rrugës lidhëse Berat – Bogdan - Parku Kombëtar i Tomorit, investim i cili pritet t'i japë zhvillim shumë të madh gjithë Rajonit, duke rritur ndjeshëm ofertën turistike të Beratit me rritjen e aksesit drejt malit të Tomorit.

Në Sinjë kemi financuar ngritjen e Muzeut Historik të Sinjës, i cili do të jetë një pike tjetër interesante për t'u vizituar. Në kuadër të projektit “100 fshatrat” kemi përgatitur projektet e zhvillimit për fshatrat Roshnik dhe Qafë - Dardhë dhe po punojmë ngushtë me komunitetet lokale për krijimin e festave dhe eventeve të lidhura me agrobiznesin, të cilat do të rrisin fluksin e vizitorëve dhe do t'i orientojnë fermerët drejt kthimit të shtëpive të tyre si bujtina të përshtatshme për vizitorët e pasionuar pas prodhimeve bio, natyrës dhe aventurës.

Sfidat tona të përditshme në Njësitë Administrative kanë të bëjnë me infrastrukturën lidhëse ndërmjet fshatrave, furnizimin me ujë, rrjetin e kanalizimeve dhe menaxhimin e mbetjeve urbane. Synojmë të rrisin cilësinë e këtyre shërbimeve që nga qendra e qytetit deri në fshatin më të largët, duke e parë Bashkinë si një qytet dhe Bashkia do të garantojë mbulimin me cilësi shërbimesh në të gjithë territorin e njësisë administrative.

Gjatë vitit 2018 me fondet e bashkisë, u bënë të mundura disa investime si:

- ✓ Rikonstruksion pjesor i palestrës së gjimnastikës;
- ✓ Rikonstruksion i shkollës “1 Maji”;
- ✓ Rikonstruksion i Muzeut Historik, Sinjë;
- ✓ Restaurimi i mureve të Kalasë së Beratit;
- ✓ Rikonstruksion i repartit të pediatrie në spitalin e Beratit, investim i cili ishte risi për Bashkinë Berat;
- ✓ Mirëmbajtje ujësjellesit, rikonstruksion i linjës “Kostren 1”;
- ✓ Rikonstruksion i fasadave në lagjen “Murat Celebiu”;
- ✓ Asfaltim dhe shtrim rrugësh me beton, mirëmbajtje me çakull dhe tombino e mure mbajtëse në Njësitë Administrative dhe lagjet e qytetit;
- ✓ Rikonstruksion i shkollës Uznovë.



BASHKIA BERAT

Investimet të cilat janë në proces zbatimi:

- ✓ Rikonstrukcion i rrugëve të brendshme dhe KUZ , fshati Morave;
- ✓ Rikonstrukcion i shkollës së mesme Starovë, Berat; me fonde te buxhetit te shtetit.
- ✓ Rikonstrukcion i fasadave në hyrje të qytetit, Berat;
- ✓ Riasfaltim segmentesh të rrugës “Antipatrea”, Berat.
- ✓ "Ndërtim i rrjetit KUZ fshati Karkanjoz, lagja “Gegallaret”, Berat;
- ✓ Ndërtim i kullës së sahatit; me fondet e buxhetit te shtetit
- ✓ Rikonstrukcion i rrugës "Stadium i vjetër - Stadium i ri", rruga "Koli Vesho", sheshit para stadiumit, shtesa e kontratës;
- ✓ Rikonstrukcion i rrugëve, trotuareve dhe ndricimit në lagjen “30 – Vjetori”, Berat;
- ✓ Rikonstrukcion i stadiumit "Tomori" në lagjen "30 - Vjetori", Berat.

Eshte punuar intensivisht për të aplikuar për çdo thirrje për projekte nga partnerët e huaj, për të përfutur investime dhe projekte me bashkëfinancime për qytetin.

Gjatë vitit 2018 u realizuan bashkëpunime me Partnerë Ndërkombëtarë, si:

- **Banka Botërore**, për financimin e projektit te zhvillimit te turizmit per Shqiperine e Jugut-financimi i dy rrugeve lidhese me Kalane, rruga “Muzakë Topia” dhe rruga “Mihal Komneno”, të cilat do të ofrojnë lehtësi për trafikun e mjeteve, parkimin, ndricimin, sheshet panoramike, por edhe do t’i shërbejnë fuqizimit të bizneseve turistike, të cilat janë të përqendruara në Qendrën Historike.

Në fazën e dytë parashikohet financimi i Bankës Botërore në shumën 15 milionë dollarë përfshirë TVSH. Projektet, të cilat do të hartohen nga specialistë të Bashkisë Berat në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, pritët të fillojnë brenda vitit 2019 dhe përfshijnë:

1. Rikonstrukcioni i fasadave pergjate rruges “Antipatrea” dhe rehabilitimi në rrugën “Antipatrea” i segmentit “Ulliri” - shkolla “22 Tetori”.
2. Rehabilitimi urban i sheshit “Iljaz Vrioni” dhe i fasadave të objekteve perreth tij.
3. Lidhja me rruge makinash (rruga SHISH - Ura e RE) dhe rehabilitimi i zones perreth + Parkim.
4. Rizhvillimi i tuneleve pergjate lumit.
5. Zhvillimi i Parkut ne brigjet e lumit.



BASHKIA BERAT

6. Rehabilitim pamor i zonave informale ne perendim.
7. Rehabilitim i anëlumit Gorice + rehabilitimi i rruges nacionale ne Gorice.
8. Restaurim i fasadave pergjate rruges “Mihal Komneno”.
9. Restaurim i peizazhit historik urban në “Goricë”.

Me **Qeverinë Zvicerane** për projektin e Mbetjeve Urbane, pritët të fillojnë së shpejti nderhyrjet emergjente në sheshdepozitim të mbetjeve dhe do të vijojë puna për sheshdepozitim rajonal të mbetjeve.

- Me Bankën Gjermane për Zhvillim **Kfë** vijon projekti i rehabilitimit të rrjetit ujësjetës – kanalizime, Berat - Kucove.

- Me Organizatën Italiane **CESVI** për projektin “Trec” në fushën e turizmit është bërë e mundur furnizimi me pajisje të Zyres së Interpretimit Turistik dhe po punohet për paketën promovionale të Beratit.

- Me **Delegacionin e BE** për Projektin “Bashkitë për Europë” është bërë e mundur ngritja e kështjellës informuese për Bashkimin Europian dhe trajnimi i stafit për të punuar me projekte të BE-së.

- Me Kompaninë **TAP** është bërë e mundur mobilimi i bibliotekës “Vexhi Buharaja” në vlerën 100 mijë euro dhe po punohet për projektin e rezervuarit të Mbreshtanit me vlerën 350 mijë euro.

- Kompania TAP ka financuar gjithashtu ndërtimin e dy shkollave në Uznovë dhe Veterik dhe ndërtimin e një kopshti për fëmijët në Dyshnik.

- Në kuadrin e Programit **IPA 2018**, Berati do të jetë pjesë e financimit nga Delegacioni i BE - së dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projekte infrastrukturorë në funksion të rritjes së turizmit. Bashkia Berat ka aplikuar për mbështetje për dy projekte; Rruga Berat – Qafë - Dardhe dhe degezimi Bodgan – Karkanjoz, Rruga Sinjë – Levan - Aranitas dhe degezimi Sinjë – Mbjeshtovë – Bistrovicë, që rrisin aksesin turistik dhe potencialet në agrobiznes në malin e Tomorit dhe malin e Shpiragut, në vlerë totale 10 milionë euro.

- Agjencia Amerikane për Zhvillim **USAID**, ka qenë prezente në fushën e financave, taksave dhe zhvillimin ekonomik për ngritje kapacitetesh dhe logjistikë për stafin e bashkisë. Në vitin 2019 do të vijojë puna në këta sektorë, duke qenë bashki e përzgjedhur ndër 5 bashkitë pilote të USAID -it në Shqipëri.

- Vazhdon projekti në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara **PNUD**, për integrimin social të popullatës romë në qytetin e Beratit dhe mbështetja për Qendrën Komunitare Romë. Me PNUD është bërë e mundur rikonstrukcioni i kopshtit “Barrikadë”,



BASHKIA BERAT

rikonstruksioni i Çerdhes nr.7 dhe rikonstruksion i KUZ tek lagjia “30 - Vjetori”, prane territorit qe banohet nga popullata rome.

- Me **Fondacionin Shqiptaro - Amerikan per Zhvillim** dhe Shoqaten BID Berati ka vijuar bashkepunimi për evente ne Zonen BID si bashkefinancimi i aktiviteteve, “ Dita e Turizmit”, “Fundjavat “, “Dita e Gatimeve Tradicionale” dhe “ Festat e Fundvitit” .

- Me Agjencine e Zhvillimit Rajonal 3 eshte bashkepunuar per Projektin “**100 Fshatrat**”, ku eshte aplikuar per 4 fshatra turistike ne Bashkine Berat dhe jane perzgjedhur 2 fshatrat: Roshnik dhe Qafe - Dardhe. Ne fshatin Roshnik do te behet i mundur rikonstruksioni i shkolles se Roshnikut.

- Me Ambasaden Gjermane eshte bere i mundur rikonstruksioni i Kopshtit “Donika Kastrioti”.

- Me Kooperimin Italian eshte bere i mundur rikonstruksioni i rruges “Santa Lucia”.

Po vijon puna për tre projekte në fushën e trashëgimisë, turizmit dhe agrobiznesit, në kuadër të Thirrjeve të **Bashkimit Evropian**, të cilat përfshijnë Programin Ndërkufitar Shqiperi – Greqi, si me poshte:

1 - Mbrojtja dhe ruajtja nëpërmjet promovimit të pjesëmarrjes (me titullin: 4ALL). Partnerë: Bashkia Berat, Instituti i Kërkimeve Urbane Tiranë, Shoqata Rajonale e Bashkive te Epirit (Greqi), Organizata ESAMEA (Greqi), Njesia Menaxhuese e Parkut Kombetar Pindos - Sit Unesco ne Greqi. Vlera e buxhetit 134 mije euro.

2 - Kontributi për forcimin e sektorit të vajit të ullirit, duke promovuar praktika të mira kultivimi, duke aplikuar teknologji precise të argikulturës, duke krijuar produkte lokale innovative dhe mbështetje për fermat e vogla. – Akronimi: Olive Culture Partnerë: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Berat, Qarku Vlore, Bashkia Nicolaos Skoufas, Universiteti Ionian. Vlera e Buxhetit 72 mije euro.

3 - Promovimi i turizmit kulturor dhe rritja e kapaciteteve – Culture Lands. **Partnere:** Bashkia Berat, Agjencia per zhvillimin e turizmit ne Maqedonine Perendimore, Universiteti i Thesalise. Vlera 59 mije euro.

Bashkia Berat gjatë vitit 2018 organizoi disa festivale dhe aktivitete, si: Dita e Trashëgimisë Kulturore, Festa e Miqësisë, Festivali Multikulturor, Porotkallia, Maratona e Këngës, Festivali FolkArt, Fundjavat në Berat, Festa e Gatimeve Tradicionale, Festat e Fundvitit, mbështetur nga buxheti i Bashkisë, në bashkëpunim edhe me donatorë.

Bashkia Berat ka investuar në drejtim të zhvillimit të sektorit të artizanatit, lehtësuar dhe asistuar artizanët e qytetit Berat. Në këtë kuadër, Bashkia ka krijuar një treg të vogël artizanati në shëtitore me qëllim nxitjen e artizanëve të vegjël prodhues të qytetit, duke i vendosur ata në kontakt me tregun turistik dhe duke i dhënë shtysë zhvillimit të iniciativave të vogla në këtë fushë.



BASHKIA BERAT

Ne bashkepunim me organizaten Flag Albania dhe me asistence te eksperteve Holadeze, kemi hartuar nje strategji per informimin e qytetareve dhe per trajnimin e kerkesave dhe ankesave te tyre.

Bashkia Berat ka ndërmarrë përpjekje domethënëse në rritjen e shërbimeve për qytetaret përmes zbatimit të konceptit **“Zyra me një ndalesë”**, përmirësimit të faqes së internetit dhe përdorimit të internetit për botimin e vendimeve të Këshillit. Këto përpjekje kanë rritur jo vetëm kontaktet dhe kërkesat, por kanë sjellë edhe rritje të ankesave.

Bashkia Berat ka krijuar **edhe një sistem të ri të regjistrimit të ankesave** (bazë të dhënash), dhe tashmë mund kontrollojë lehtësisht se cilat janë çështjet më urgjente për t'u zgjidhur.

Nje sistem i **ri ankimimi online** do te shtrihet edhe ne Njesite Administrative te reja te Bashkise Berat, ku do te mund të ofrohet shërbim direkt për qytetaret dhe kthim përgjigje për praktikën e tyre në çdo fshat apo njesi të largët.

Ne fushën e shërbimeve publike kemi synuar efektivitet ekonomik të shprehur në sasinë e shërbimeve, në organizimin dhe menaxhimin e tyre.

Krahas shtimit të sipërfaqeve, vëmendje do t'i kushtohet edhe:

- mirëmbajtjes të rrjetit ekzistues të ndriçimit publik në gjithë territorin e bashkisë.
- mirëmbajtjes së kalldremeve, rrugëve dhe shesheve të asfaltuar dhe jo vetëm.
- mirëmbajtjes së rrjetit rrugor në gjithë shtrirjen territoriale të bashkisë.
- përmirësimin e shërbimit të pastrimit në qytet, unifikim të shërbimit në njesitë e reja.
- mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta.
- mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe çlodhese etj.

Pjesë e rëndësishme në vizionin tonë është dhe do të jetë ndjekja e:

- Furnizimit me ujë të pijshëm.
- Shërbimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.
- Mbikëqyrja e shërbimit të transportit urban.
- Gatishmeri dhe përgjigje ndaj Emergjencave Civile.
- Shërbimi social dhe mirëfunksionimi i qendrave sociale / komunitare.
- Mirëmbajtje të objekteve arsimore në gjithë territorin e bashkisë.
- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike dhe sportive.

Projektbuxheti i vitit 2019 dhe PBA 2019-2021, në kuadrin e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, është hartuar duke zhvilluar seanca të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët, në 4 Njesitë Administrative, 3 lagjet e qytetit, grupet e interesit dhe shoqëri civile.

Disa konkluzione për PLAN BUXHETIN 2019:

- Bashkia Berat në planifikimin e të ardhurave është mbështetur në realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2016 dhe 2017, pritshmerinë e vitit 2018, si dhe në Paketën Fiskale, miratuar me VKB -në nr. 57, datë 28.12.2015 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat”, i ndryshuar me VKB -në “Për disa shtesa dhe ndryshime të këtij Vendimi”, krahas Udhezimeve dhe VKM -së për sistemin e taksave.



BASHKIA BERAT

- Planifikimi I te ardhurave vendore ka reflektuar ndryshimet ligjore ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ku taksa mbi ndërtesat dhe tabelat për qëllime identifikimi dhe reklamimi, me **efekt negativ** ne te ardhurat nga taksa mbi ndërtesat për qëllime biznesi është 24,303,000 lekë, pra në planifikim janë më pak nga planifikimi i vitit 2018.
- Efekt negative ka dhe taksa mbi tabelat ne Shumen 5,996,000 lekë, pra në planifikim janë më pak nga planifikimi i vitit 2018, efekt I ndryshimeve ligjore.
- Ligji 140/2016 për disa ndryshime në ligjin nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” pezullon aktivitetin e lojrave të fatit, duke filluar nga data 01.01.2019, Njësine Administrative Berat kanë ushtruar aktivitetin e tyre 93 subjekte. Si rrjedhoj pakesohen te ardhurat për tarifën e pastrimit me 3,720,000 lekë, ndricim 558,000 lekë, gjelbërim 325,500 lekë, gjithesej efekt prej 4,603,500 lekë më pak në planifikimin e tarifave të vitit 2019.
- Plan Buxheti i vitit 2019 eshte hartuar nga Bashkia Berat, mbeshtetur ne Udhhezimet perkatese te ardhura nga Ministria e Financave, duke ndjekur ne menyre korrekte fazat e pergatitjes se tij.
- Plan buxheti 2019 parashikon politika lehtesuese per Bizneset e hapura**, nga familjet e reja,dhe te drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësité Administrative, kjo tarifë paguhet ne 20% me ulët te tarifës normale. Për Familjet me një prind, me fëmijë deri në moshën 22 vjec,që janë në vazhdimësi të arsimimit, per të gjitha Njësité Administrative, kjo tarife paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.
- Bashkia Berat ne hartimin e Plan Buxhetit 2019 parashikoi shpenzimet sipas programeve buxhetore duke marre ne konsiderate edhe problematikat e dala nga degjesat publike.
- Plan Buxheti 2019 (plani i shpenzimeve) eshte mbeshtetur ne te njejtin numer punonjesish si ne vitin 2018.
- Nepermjet implementimit te Plan Buxhetit 2019 do te synojme rritja e **cilësisë së shërbimeve publike në territorin e qeverisjes vendore.**
- P/Buxheti 2019 do te mbeshteti permiresimin e infrastrukrures arsimore** nepermjet mirembajtjes se institucioneve arsimore ne gjithe territorin e bashkise si dhe mirembajtja e cerdheve te qytetit.
- Edhe gjate vitit 2019 do te vijoj mirembajtja e te gjitha rrugeve, shesheve, trotuareve te asfaltuara e me kalldrëm,** duke kryer shpenzime te mirembajtjes se tyre si dhe mirembajtjen e rrugeve rurale ne inventarin e bashkise,
- MFE e ka vlerësuar projektdokumentin gjate fazes se pare, hartuar nga Bashkia Berat, duke e kthyer këtë proces në një proces gjithëpërfshirës, njekohesisht ka orientuar Bashkine Berat ne **prioritetet qe i duhen dhene shpenzimeve per investime ne raport me shpenzimet operative.**
- Ne Plan Buxhetin e vitit 2019 nuk jane perfshire te ardhurat e trasheguara nga viti 2018, pasi rezultati perfundimtar do te dale pas rakordimit te të ardhurave dhe shpenzimet te realizuara deri me 31 dhjetor 2018, procedure qe kryhet ne janar 2019 me



BASHKIA BERAT

degen e thesarit. Kjo shume do te miratohet në mbedhjen e Keshillit Bashkiak te fillimvitit 2019 .

Ky projektbuxhet, mbeshitetur ne parimin e transparences, parashikueshmerise, gjithheperfshirjes etj., ka shprehur nevojat, kerkesat dhe pritshmërite e bashkëqytetarëve tanë, dhe besojme se është zbatim i përgjegjësive ligjore, detyrimeve dhe angazhimeve të marra përsipër nga Bashkia Berat.

Te nderuar keshilltar, ju uroj suksese ne zhvillimin e kesaj mbedhje, ne diskutimin, analizimin dhe vleresimin e ketij dokumenti nga me te rendesishmit qe Vendimon Keshilli Bashkiak!

Mirenjohje per mbeshtetjen e vazhdueshme qe Keshilli i Bashkise Berat, i ka dhene gjate ketyre viteve ekzekutivit te bashkise ne realizimin e misionit ne sherbim te komunitetit!

Shpreh bindjen se bashkepunimi, mirekuptimi dhe mbeshtetja juaj do te jete edhe ne miratimin e ketij projektbuxheti.

Gezuar festat e fundivitit, mbaresi ne familjet tuaja dhe mbare komunitetit te Bashkise Berat!

Ju faleminderit!

Me respekt, Petrit SINAJ

KRYETAR I BASHKISE BERAT



BASHKIA BERAT

HYRJE

Bashkia Berat hartoi Programin Buxhetor Afatmesëm (P B A), mbështetet në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjin nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 41 "Buxheti i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe program buxhetor afatmesëm", citon:

Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.

Ne zbatim të ligjit nr. 68 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Mbeshteje dhe ndihmese e rendeshishme gjate punes sone jane miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit "Për financat e vetëqeverisjes vendore" si:

- të procedurave standarte për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore,
- përdorimi i një instrumenti të ri për planifikimin financiar dhe hartimin e programit buxhetor afatmesëm që standardizon mënyrën e paraqitjes së informacionit buxhetor;
- unifikimi i programeve buxhetore të standartizuara për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- mbështetja dhe monitorimi i procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë vetëqeverisjes vendore;
- zhvillimi i seancave degjimore dhe konsultative midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore; si dhe
- hyrja në fuqi e udhëzimit për vështirësitë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Roli kryesor i PBA-së është që të sigurojë që politika , objektivat dhe qëllimet të jenë të përcaktuara qartë dhe se programet dhe produktet e synuara do të arrijnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon një përdorim ekonomik eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore në një process vashdimësie.

Jemi perpjekur qe qëllimet dhe objektivat të jenë në përputhje me dokumentet strategjike të zhvillimit dhe të planifikimit të politikave sektoriale të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

PBA është i vetmi instrument që bën të zbatueshem planin strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore për një periudhë trevjecare.

Programi Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 i Bashkisë Berat është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të Bashkisë, bazuar në funksionet e pushtetit vendor të përcaktuara në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në strukturat buxhetore të



BASHKIA BERAT

programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht Bashkia Berat.

Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program buxhetor. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse.

Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioritetëve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2019 -2021 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e të 4 njësisë administrative, 3 lagjet e qytetit, grupet e ineresit dhe komisionin qytetar, gjithashtu edhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për vitet 2015-2019.

Projekt-buxhetet bazohen në **VIZIONIN** tonë për Beratin e së ardhmes :

Berati i lashtë, qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore, me një komunitet që i gëzohet zhvillimeve harmonike dhe mundësive të barabarta, një qendër e turizmit ndërkombëtar, me ekonomi dinamike të mbështetur në agrobiznes dhe artizanat të konsoliduar.

Vizioni mbështetet në kater Objektiva Strategjike:

1: Qendër Ndërkombëtare e Turizmit Kulturor, mbështetur në turizmin familjar, që ruan dhe zhvillon trashëgiminë e tij unike kulturore, historike dhe arkitekturore.

2: Zhvillimi i harmonizuar i një ekonomie konkurruese në tregun rajonal, me biznese kryesisht të agrobiznesit e artizanatit, që zgjerohen e inkurajohen për të pasur diversitet e cilësi.

3: Zhvillimi i ekuilibruar i territorit në përputhje me parametrat bashkëkohore mjedisore dhe urbane dhe në harmoni me tiparet specifike të trashëgimisë së qytetit.

4: Një jetë sociale cilësore, dinamike dhe gjithëpërfshirëse ku shanset individuale për progres dhe mirëqenie mbështeten e zgjerohen në mënyrë të barabartë.

Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, i lidhur mirë me zonat e qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukture të rishtrukturuar, si një destinacion i fuqishëm turistik dhe portë hyrëse/pritëse për një rajon të pasur natyror.

Programi Buxhetor Afatmesëm në fokus ka: Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial, nëpërmjet shpërndarjes së drejtë të burimeve financiare duke prekur gjithë njësitet administrative të bashkisë Berat.

Nëpërmjet hartimit dhe implementimit të PBA por jo vetëm , Bashkia Berat do të realizoi misionin e Qeverisjes Vendore sipas nenit 3 të Ligjit 139/2015, që citon:



BASHKIA BERAT

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera

OBJEKTIVAT E BUXHETIT TE BASHKISE BERAT PER VITIN 2019.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2019 do të jetë në funksion të :

1. vazhdimin të zbatimit të reformës administrativo- territoriale
2. decentralizimit fiskal të njësisë të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet
 - *Rritjes së nivelit, stabilitetit dhe parashikueshmërisë së transfertave ndërqeveritare.*
 - *Konsolidimit të procedurave dhe sistemit të menaxhimit të financave vendore në të gjitha hapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij.*
 - *Sigurimit të menaxhimit financiar transparent dhe efektiv për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;*
 - *Planifikimit dhe buxhetimit eficient dhe të mirë-integruar i shpenzimeve publike në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj qyteratëve dhe përdorimit me ekonomi të fondeve vendore;*
 - *Unifikimit të standardeve të procesit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm dhe programimi mbi bazën e një sistemi të unifikuar programesh;*
 - *Përmirësimit të cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor dhe krijimi i një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.*
 - *Garantimit të një sistemi të financave publike vendore që nxit transparencën, përgjegjshmërinë dhe eficiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike.*
 - *Implementimit të një metodologjie të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore.*

I. Objektivat e Bashkise Berat per Plan buxhetin 2019:



BASHKIA BERAT

1. **Realizimi i planit të ardhurave** nga Taksat dhe Tarifat vendore, duke maksimizuar arketimet prej tyre, nepermjet shtimit të bazës së taksapaguesve, (shtimit të numrit të tatim paguesve), dhe jo nëpërmjet rritjes së nivelit të taksimit, porveç atyre të ndyshuara me akte ligjore.
2. **Rritja** e të ardhurave të bashkisë nëpërmjet një **menaxhimit sa më të mirë të pronave të bashkisë**, rritjen e numrit të pronave të regjistruara në Z.R.P.P, me qëllim rritjen e numrit të ambjenteve të dhëna me qira ose kontrata të tjera si dhe monitorim sa më efikas i tyre.
3. **Objektiva emergjente në fushën e Menaxhimit të integruar të Mbetjeve**
 - Parashikimi në P/Buxhet të kostove sipas VKM Nr. 319 ,date 31.05.2018 “ Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”.
 - Në Njesite Administrative ku aktualisht ofrohet shërbimi , bashkia do të rrisë standartin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve
4. Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe punësimit në vend, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe përmirësimi i klimës së biznesit përmes **dhënies dhe aksesit të lehtësuar të informacionit për të bërit biznes në Berat.**
5. **Përmirësimin e raportit midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale** në favor të atyre kapitale duke respektuar edhe rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë shqyrtimit të draftit të parë të PBA 2019-2021.
6. **Politika lehtësuese për Bizneset e hapura**, nga familjet e reja, dhe të drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë paguhet në 20% me ulët të tarifës normale. Për Familjet me një prind, me fëmijë deri në moshën 22 vjeç, që janë në vazhdimësi të arsimimit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.
7. **Gjallërimin e jetës social - kulturore dhe artistike nepermjet mbështetjes së aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive në qytet** në bashkëpunim me donator dhe partner vendas dhe të huaj për të gjallëruar jetën e qytetit.
8. Plan Buxheti 2019 do të synohet rritja e **cilësisë së shërbimeve publike në territorin e qeverisjes vendore.**
9. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka nisur **monitorimin periodik mbi ekzekutimin e pagesave (likuidimin) e detyrimeve të prapambetura** për çdo institucion buxhetor. Në këtë kontekst **objektivi ynë është shkëputja e borxheve dhe rikrijim detyrimesh.**

II. Plan buxheti 2019 synon:



BASHKIA BERAT

- ✓ **Vijimin e punes nga gjithë administrata e bashkise per maksimizimin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore.**
- ✓ **Planifikim dhe menaxhim korrekt i** te gjitha te ardhurave qe krijon ne bashki nga pronat bashkiake, dhe te ardhurat qe krijojne Drejtorite ne varesi te bashkise.
- ✓ **Forcimi i disiplinës fiskale**, duke respektuar rregullat dhe parimet e sanksionuara me ligj ne hartimin, konsultimin, miratimin, e te ardhurave duke synuar një menaxhim të shëndoshë financiar.
- ✓ **Evidentimin dhe rregjistrimin real** te cdo taksapaguesi si dhe zbatimin e procedurave efektive për te thjeshtuar marredheniet e tatimpaguesit me administraten tatimore vendore.
- ✓ **Permiresimin e raportit brenda shpenzimeve operative** , duke **planifikuar ato shpenzime qe jane me te domosdoshme** duke respektuar edhe rekomandimet e dhena nga Ministria e Financave dhe Ekonomise gjate shqyrtimit te draftit te pare te PBA 2019-2021, ne lidhje me peshen specifike qe zene shpenzimet operative ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore.
- ✓ **Mirembajtjen e te gjitha rrugeve, shesheve, trotuareve te asfaltuara e me kalldrëm** duke kryer shpenzime te mirembajtjes se tyre si dhe mirembajtjen e rrugeve rurale ne inventarin e bashkise.
- ✓ **Rritjen e hapësirave te gjelberta** nepermjet kyerjes se te gjitha shërbimeve teknologjike ne parqet ekzistuese, shtimit te sipërfaqeve me lule sezonaledhe mbjelljes se pemeve e drureve dekorativ te reja.
- ✓ **Implementimin e menaxhimit te integruar** te mbetjeve te ngurta urbane , ne zbatim dhe te VKM nr.319 date 31.05.2018, mbeshteje financiare e projektit për “Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta” në Qarkun e Beratit i financuar nga Ambasada Zvicerane.
- ✓ **Permiresimin e infrastrukrures arsimore** nepermjet mirembajtjes se institucioneve arsimore ne gjithë territorin e bashkise si dhe mirembajtja e cerdheve te qytetit.
- ✓ **Permiresimin e infrastrukrures kulturore dhe sportive** nepermjet kryerjes se shpenzimeve te mirembajtjes se objekteve kulturore dhe atyre sportive , duke perqendruar vemendjen te palestrat.
- ✓ **Vijimin e investimeve** te nisura nga viti 2017 , 2018 dhe shtimin sasior dhe cilësor të investimeve kapitale ne vitin 2019 me ndikim te drejteperdrejte ne zhvillimin ekonomik te Bashkise.
- ✓ **Harmonizimin e kërkesave** te komunitetit te dala nga dëgjesat publike me planet sektoriale te bashkise dhe te ndermarrjeve dhe institucioneve ne vartesi te saj.
- ✓ **Balancim i kërkesave me te domosdoshme te komunitetit me mundësitë financiare.**
- ✓ **Shlyerjen e te gjitha detyrimeve** per investimet ne proces nga viti 2017, dhe fillimin e vitit buxhetor 2019 **pa borxhe** e moskrijim detyrimesh te reja.



BASHKIA BERAT

1.2 INFORMACION PERMBLEDHES PER PERGATITJEN E BUXHETIT TE VITIT 2019 DHE PBA 2019-2021.

Programi Buxhetor Afatmesem është i vetmi instrument që bën të zbatueshem planin strategjik të zhvillimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore për një periudhë trevjeçare.

Me Urdhërin Nr. 169 datë 15.03.2018 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe janë krijuar Ekipet e Menaxhimit të Programit për menaxhimin dhe sigurimin e zbatimit të sistemit të planifikimit të integruar në përgatitjen e PBA 2019-2021.

PBA është hartuar në përputhje me standartet bashkekohore si dhe mbështetet në trajnimet e specialisteve të finances, tatim - taksave, shërbimeve publike, urbanistikes, burimeve njerezore, prokurimeve etj. të organizuara nga Ministria e Finances, Ministria e Brendshme, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, USAID-i , DPDL, Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit si dhe mbështetur në përvorjet pozitive të akumuluar të stafit të bashkisë apo dhe të njesive të tjera vendore.

MFE e ka vlerësuar projektdokumentin e hartuar gjatë fazës së parë nga Bashkia Berat duke e kthyer këtë proces në një proces gjithëpërfshirës.

- Projektdokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të Bashkisë Berat është përgatitur në Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT);
- Bashkia Berat ka respektuar afatin ligjor të paraqitjes së projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, të përcaktuar në ligjin 68/2017 “Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit Plotësues Nr. 6/1, datë 28.02.2018, “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në vijim udhëzimi plotësues.
- Raportet e projektdokumentit të PBA-së, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë sipas formateve të përcaktuara në udhëzimin plotësues;

Bashkia Berat në procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, ka marrë vendime të rëndësishme në nivel strategjik dhe buxhetor, duke i përkthyer ato në tavane shpenzimesh.

Bashkia Berat ka zhvilluar programe buxhetore për të cilin ka identifikuar burimet që do të përdoren për të realizuar projektet.



BASHKIA BERAT

Ne lidhje me rekomandimin e MFE , Administrata e bashkise reflektoi ne lidhje me vërerjen: **totali i shpenzimeve operative ndaj totalit të shpenzimeve është shumë i lartë**, ne hartimin e planit te detajuar te shpenzimeve operative gjate parashikimit te vitit 2019, duke vleresuar maksimalisht kryerjen e atyre shpenzimeve operative me te domosdoshme, minimizuar shpenzimet administrative dhe eleminuar shpenzimet jo productive , nisur nga fakti I 10- mujorit dhe pritshmeria e vitit 2018, jo vetem per aparatin administrative te bashkise por edhe te njesive shpenzuese:

Shpenzimet për investime në totalin e shpenzimeve duhet të kenë një peshë specifike më të lartë për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të njësisë dhe konsolidimin e pozitës fiskale, kjo moto shoqëroi punën tone gjate hartimit te detajuar te Plan buxhetit te vitit 2019, duke adresuar edhe problematikat e dala nga degjësas publike te zhvilluar gjate fazes se pare te diskutimit te Draftit PBA 2019-2021.

Per te finalizuar procesin e pergatitjes se dokumentit perfundimtar te P/Buxhetit 2019 dhe PBA 2019-2021 u hartua plani I masave dhe veprimi ku jane te percaktuar aktivitetet qe do te zhvillohen, afati, personat pergjegjes. Ky plan masash dhe veprimi eshte bere ne perputhje me kerkesat e *Ligjit nr. 68/2017 "Per financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjin 9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise"*.

Plani I veprimit, procsverbalet e degjësave publike si dhe lista e pjesmarreseve jane pjese e dokumentave te pergatitjes dhe miratimit te PBA 2019-2021.

Bashkia Berat zhvilloi dëgjesat publike me lagjet Nr.1.2.3 të Bashkisë Berat, Njësite administrative Otlak , Sinje, Velabisht, Roshnik, me grupet e interesit, dhe Komisionin Qytetar, si **konsultime me komunitetin duke tërhequr mendimet e sygjerimet e tyre**,

U kryen keto aktivitetet:

Aktiviteti nr. 1 : Organizimi I degjësave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit dhe njesite administrative.

Aktiviteti nr. 2 Organizimi I degjësave publike me grupet e interesit; komisionin qytetar,

Aktiviteti nr. 3 Zhvillim i degjësave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit , njesite administrative dhe grupet e interesit:

Aktiviteti nr. 4 Miratimi i dokumentit te rishikuar te PBA 2019-2021.

1. Pergatitja e materialit te rishikuar te Programit Buxhetor Afatmesem 2019 -2021 , Miratimi ne Keshillin Bashkiak
2. Dergimi i materialit ne Ministrine e Financave, brenda 15 shtatorit 2018.



BASHKIA BERAT

Propozimet e terhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u percollen njesive shpenzuese te vartesis se bashkise per ti integruar ne programet perkatese buxhetore, sipas listimit te prioriteteve brenda mundesive financiare.

Paraqesim me poshte problematikat te marra nga raporti permbedhes I pergatitur nga organizimi I degjesave ne cdo njesi administrative, lagjet e qytetit dhe grupet e ineteresit dhe komisioni qytetar:

1. KOMISIONI QYTETAR:

- Të rishikohet çështja e shpenzimeve joproduktive;
- Të rishikohet çështja e pastrimit të qytetit, pasi derimë tani paraqet një perceptim jopozitiv në sytë e banorëve, por edhe të vizitorëve; te shtohet dita e diele ne pastrimin dhe largimin e mbetjeve urbane.
- Vëmendja të mos përqëndrohet vetëm në Qendrën Historike të qytetit, por të shihen me përparësi edhe lagjet e tij periferike.

KËRKESAT E BANORËVE NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore në akset kryesore e dytësore të Lagjeve dhe Njësive Administrative;
- Përmirësimin e rrjetit të ujësjellës - kanalizimeve;
- Furnizimin me ujë të pijshëm duke reduktuar kufizimet e duke përmirësuar rrjetin e shpërndarjes;
- Zgjidhjen e problemit të rrugëve në parcelat bujqësore;
- Vënien në funksion të plotë të kanaleve kulluese dhe vaditëse në disa prej Njësive Administrative;
- Krijimin e këndeve çlodhëse, argëtuese dhe sportive në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë;
- Funksionimin e rrjetit të ndriçimit atje ku ky rrjet ekziston;
- Përmirësimin e infrastrukturës në çerdhe, kopshte dhe qendra shëndetësore.

Propozimet e terhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u percollen njesive shpenzuese te vartesis se bashkise per ti integruar ne programet perkatese buxhetore, sipas listimit te prioriteteve brenda mundesive financiare.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara :

- I. Gjatë punës sonë të përditëshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- II. Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë.
- III. Nga kërkesat dhe ankesat e qytetareve adresuar administratorëve te lagjeve dhe njesive administrative.
- IV. Nga degjesat publike organizuar pas fazes se pare te pergatitjes se PBA.



BASHKIA BERAT

Viti 2019 është viti i parë i PBA 2019 -2021 , ne këtë kontekst kërkesat buxhetore të vitit 2019 janë të harmonizuara me politikat dhe objektivat afatmesme 2019-2021

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavaneve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhura vetë parashikuara. Parashikimi buxhetor është i balancur.

Dokumentet mbi të cilët është mbështetur hartimi i Programi Buxhetor Afatmesëm dhe buxheti vjetor 2019 janë:

- i. Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë
- ii. Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit
- iii. Strategjitë sektoriale që janë të lidhura me kompetencat e pushtetit vendor

Planifikimi I të ardhurave vendore ka reflektuar ndryshimet ligjore

- ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ku taksa mbi ndërtesat dhe tabelat për qëllime identifikimi dhe reklamimi, me efekt negativ në të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat për qëllime biznesi është 24,303,000 lekë, pra në planifikim janë më pak nga planifikimi i vitit 2018.
- ne ligjin 140/2016 për disa ndryshime në ligjin nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë ku aktiviteti i lojrave të fatit do të mbyllet duke filluar nga data 01.01.2019, në Njësinë Administrative Berat kanë ushtruar aktivitetin e tyre 93 subjekte. Efekti negativ : Për tarifën e pastrimit ka efekt 3,720,000 lekë, ndricim 558,000 lekë, gjelbërim 325,500 lekë. Kjo jep një efekt prej 4,603,500 lekë më pak në planifikimin e tarifave të vitit 2019.

2. FINANCIMET E BASHKISË BERAT PËR VITIN 2019

1.3 Plani financiar i periudhës afatmesme 2019-2021.

Bashkia Berat , si burimi financimi të shpenzimeve vendore për vitin 2019, do të ketë të ardhurave vendore të planifikuara (Plani i të ardhurave vendore gjithësej) dhe transfertat e pakushtëzuar të përgjithshme.



BASHKIA BERAT

Skema e financimit të funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, dhe të financuara me transfertë specifike, në buxhetin e vitit 2019 dhe në vijim do të jetë transfertë e pakushtëzuar për sektorë të veçantë. Këto transfertë mund të përdoren në autonomi nga Bashkitë.

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavaneve të shpenzimeve është brënda kontekstit të të ardhura vetë parashikuara. Parashikimi buxhetor është i balancur.

Plani financiar i Bashkisë Berat për vitin 2019 dhe krahasimi me planifikimin e vitit 2017 dhe 2018

000/lek

Nr.	Pershkrimi	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2018 I #	Viti 2019
I	Totali i te ardhurave	997,993	1,010,163	1,164,990	1,036,051
1	Total Transferta	546,586	527,438	622,349	537,085
a	Transferta e pakushtëzuar	255,250	277,104	277,104	285,474
b	Transferta e pakushtëzuar trasheguar nga viti paraardhës	21,206		42,052	
c	Transferta Specifike	233,868	250,334	250,334	251,611
d	Transferta e Specifike trasheguar nga viti paraardhës	36,262		52,859	
2	Total te ardhura te veta	451,407	482,725	542,641	498,966
a	Te ardhura te veta	430,427	482,725	505,071	498,966
b	Te ardhura te veta trasheguar nga viti paraardhës	20,980		37,570	
II	Totali i Shpenzimeve	997,993	1,010,163	1,164,990	1,036,051
1	Totali shpenzime operative	762,604	772,743	840,801	766,951
a	Shpenzime personeli	461,216	492,568	490,970	499,150
b	Shpenzime operative	301,388	280,175	349,831	267,801
2	Shpenzime kapitale	235,389	237,420	324,189	269,100

Parashikimi i treguesve ekonomik-financiar për periudhën 2019 -2021 është mbështetur në kriteret e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave ,

Plani financiar i Bashkisë Berat për periudhën afatmesme 2019-2021

Nr.	Pershkrimi	viti 2019	viti 2020	viti 2021
I	Totali i te ardhurave	1,036,051	1,069,693	1,114,982
1	Total Transferta	537,085	555,758	585,629
a	Transferta e pakushtëzuar	285,474	304,147	334,018
b	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	251,611	251,611	251,611



BASHKIA BERAT

2	Total te ardhurat e veta	498,966	513,935	529,353
II	Totali i shpenzimeve	1,036,051	1,069,693	1,114,982
1	Totali i shpenzimeve operative	766,951	802,145	820,244
	Shpenzime personeli	499,150	512,787	526,784
	Shpenzime operative	267,801	289,358	293,460
2	Shpenzime kapitale	269,100	267,548	294,738

2.2 TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E VITIT 2019.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (TP) për vitin 2019 është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të parashikuar për vitin 2019, ose 17,527,360,000 Lekë, 6.1 % ose rreth 1 miliard lekë më shumë se në vitin 2018.

Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe bashkitë në Lisën e UNESCO-s, inkorporoheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive.

Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë.

Në vitin 2019, në zbatim të nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, do të ndërmerret një reformë në sistemin e financave të arsimit parashkollor duke e harmonizuar sistemin me praktikat më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve.

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes



BASHKIA BERAT

Vendore”., por ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kritereve specifike të përcaktuara në Aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019.

Buxheti i vitit 2019, shënon fillimin e një reforme të rëndësishme në sistemin arsimor dhe vendos një standard të ri në arsimin parashkollor.

Duke filluar nga viti 2019, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, fondet për arsimin parashkollor do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3-6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në 2018.

Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 19369 datë 30.10.2018 “Dërgohet për njoftim Transferta e pakushtezuar e përgjithëshme dhe sektoriale për vitin 2019”, bashkia Berat i është akorduar transfera e pakushtezuar në shumën 285 474 000 lek ose 3% më shumë se viti 2018

Që ishte në vlerë absolute në Shumën 277 104 000 lek,

Për vitin 2017 kjo transfera ishte në shumën 255 250 000 lek, krahasuar me vitin 2017 rritja është 8.56% më shumë, në vlerë absolute rritja është në shumën 21 854 000 lek.

Në vitin 2016 që ishte viti i parë pas zbatimit të Reformës Teritoriale dhe funksionit të 61 bashkive, bashkia Berat i akordohet 219 580 000 lek transfera e pakushtezuar.

Transferta e pakushtezuar për vitin 2017 për Bashkinë Berat është 255 250 000 lek, *kundrejt 219 580 000 lek që ishte në vitin 2016, ose 16% më shumë se në vitin 2016.*


Në vitin 2018 për Bashkinë Berat akordohet transfera e pakushtezuar në shumën 277 104 000 lek, ose 8.5% më shumë se viti 2017.

Në vitin 2019 akordohet transfera e pakushtezuar në shumën 285 474 000 lek, ose 3% më shumë se viti 2018. Shënim në vlerë absolute në shumën 8 370 000 lek

Paraqitja Grafike:



BASHKIA BERAT



2.3 Transferta sektoriale e vitit 2019.

Fondet e planifikuara për vitin 2019 nga transferta sektoriale (specifike) dhe krahasimi me vitin 2016 , 2017 , 2018 paraqiten si me poshte:


ne 000/leke

Emertimi i Funkcionit	P/2016	P/2017	P/2018	P/2019
Sherbimi zjarrfikës	26,565	29,175	30,550	30,550
Mbrojtja Sociale	22,416	22,864	23,496	23,731
Arsimi Parashkollor dhe ai baze	117,645	126,099	132,005	132,152
Konv. ars. Paraunivers/Sherb Mbesht. Ars. i mesem	32,868	34,276	40,682	40,953
Administrimi i Pyjeve	2,453	3,313	4,575	8,745
Ujitja dhe kullimi	12,459	13,411	14,250	14,250
Rrugët Rurale	4,636	4,729	4,776	4,824
Transferta Sektoriale total	213,042	233,867	250,334	251,611



BASHKIA BERAT

Paraqitja Grafike.



Funksionet që financohen me transferta sektoriale për vitin 2019:

Konviktet e arsimit parauniversitar. Në transfertën specifike të vitit 2019, bashkive ju akordohen fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, datë 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendësudrejtor dhe edukator). Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH). Në transfertën sektoriale të vitit 2019, janë fondet për Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar. Në transfertën sektoriale të vitit 2019, janë fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit



BASHKIA BERAT

parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Rrugët rurale. Në transfertën sektoriale të vitit 2019, janë fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative.

Administrimi i pyjeve. Në transfertën sektoriale të vitit 2019, janë fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ujitja dhe Kullimi. Në transfertën sektoriale të vitit 2019, janë fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Pasqyre permbedhese e transfertave:

ne 000/leke

Vitet	2016	2017	2018	2017/2016	2018/2017	P.2019	2019/2018
Transferta e pakushtezuar	219,580	255,250	277,104	1.16%	1.09%	285474	103%
Transferta Specifike	219,042	233,867	250,334	1.10%	1.07%	251611	100.5%
Totali Transfertave	438,622	489,117	527,438	1.13%	1.08%	537085	101.8%

2. 4 Transferta të Kushtëzuara per funksione te deleguara.

Transferta e kushtëzuara në buxhetin e vitit 2019, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara (Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për QKR, dhe shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të gjëndjes civile. Këto fonde do të përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë. Per buxhetin e vitit 2018 transferta e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Berat do konfirmohet nga Ministrite e linjes gjate vitit 2018.

Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.

Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së linjes. Ato ju delegohen njësitë të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmës ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore. Per buxhetin e vitit 2018



BASHKIA BERAT

transferta e kushtezuar që do akordohet për Bashkinë Berat, do konfirmohet nga Ministritë e linjes.

2.5 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe Programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.
3. Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.
4. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.
2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financim të projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
3. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit.
4. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të
5. kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

2.6 PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE

PLANI I TË ARDHURAVE NË DREJTORINË E TAKSAVE DHE TARIFAVE PËR VITIN 2019.

Të ardhurat nga Taksat dhe Tarifat

Bashkia Berat në planifikimin e të ardhurave është mbështetur në realizimin faktik të të ardhurave të vitit 2016 dhe 2017, pritshmerine e vitit 2018, si dhe në Paketën Fiskale, miratuar me VKB -në nr. 57, datë 28.12.2015 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në



BASHKIA BERAT

Bashkine Berat”, i ndryshuar me VKB -në “Per disa shtesa dhe ndryshime te ketij Vendimi”, krahas Udhezimeve dhe VKM -së per sistemin e taksave

Si çdo vit planifikimi i të ardhurave të vitit 2019 është kryer në mënyrë analitike, duke ju referuar çdo takse dhe tarife vendore, të cilat analizohen në hollësi. Çdo e ardhur është planifikuar në bashkëpunim me punonjësit të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejtë në punën e tyre me arkëtimet nga taksat dhe tarifat vendore. Këtu bën pjesë gjithë stafi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, stafi njësive administrative Roshnik, Sinjë, Otlak, Velabisht.

Viti 2019 është viti i katërt që planifikojmë të ardhurat e Bashkisë “së madhe” Berat në të cilën përfshihet një territor më i gjërë. Natyrisht që një planifikim i tillë paraqet akoma më shumë vështirësi kjo për faktin se 4 njësitë administrative kanë burime financiare tepër të kufizuara.

Gjithashtu paraqet shumë vështirësi mbulimi i shpenzimeve të këtyre njësive me të ardhurat që ato vetë do realizojnë. Si rrjedhojë shpenzimet e tyre do mbulohen nga të ardhurat që do sigurojë Bashkia Qëndër.

Në qytetin e Beratit për vitin 2018 ushtrojnë aktivitetin ekonomik 1907 biznese, nga të cilat 1496 janë biznese të vogla të cilat mbështeten kryesisht në shërbime e më pak në prodhim. Ato ndahen si më poshtë: 30 biznese Restorante, Piceri; 108 biznese Prodhimi; 525 biznese Tregti me pakice; 219 biznese Bar Kafe; 119 biznese Ushqimore; 112 biznese Profesione te lira; 284 biznese sherbimi; 54 biznese transporti; 45 biznese Ambulant

Bizneset e mëdha ndahen në: 255 biznese import-eksport; 25 biznese ndërtimi; 48 biznese prodhimi; dhe 83 biznese transporti.

Biznesi i madh mbështetet kryesisht në import-eksport, fusha e dytë është ndërtimi, dhe prodhimi.

Në rang njësie administrative bizneset të mëdha dhe të vogla shpërndahen në territor si vijon: 264 në Otlak; 161 në Velabisht; 41 në Sinjë dhe 27 në Roshnik. Në njësitë Otlak, Velabisht, Sinjë dhe Roshnik numri i bizneseve të mëdha e të vogla për vitin 2018, që ushtrojnë aktivitetin ekonomik është më i ulët.

Njësia Otlak është njësia që ka numrin më të lartë të bizneseve, kjo për shkak të aksesit dhe lidhjes me qytetin e Beratit. Numrin më të vogël të bizneseve që ushtrojnë aktivitetin e tyre e ka Roshniku, kjo si pasojë e mungesës së shërbimeve dhe aksesit të ulët me Beratin.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2019 mbështetet kryesisht në :

- Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2018, me ndryshimet përkatëse.
- Ruajtjen e qëndrueshmërisë të nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.



BASHKIA BERAT

- Parashikimin e të ardhurave nga agjentët tatimorë,
- Thellimin e vazhdueshëm të punës në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të subjekteve të paregjistruar në organet tatimore.


Ecuria në vite e të ardhurave që mbliidhen nga agjentet tatimore në /000 lekë

Vitet	Fakt 2016	Fakt 2017	Plani 2018	Fakti 10 Mujori - 2018
Taksa + Tatimi	8,104	4,014	6,761	1,939

Ndjekja e këtij tatimi i kaloi Drejtorive Rajonale Tatimore në rolin e agjentëve tatimorë, shërbim për të cilin përfitojnë 1% të vlerës së arkëtuar. Shihet se, realizimi i të ardhurave nga ky zë është më i ulët në raport me të ardhurat në vitet e mëparshme, kur këto të ardhura mbliidheshin nga Bashkia Berat. Madje në këtë drejtim janë bërë hapa pas, pasi edhe duke arkëtuar të ardhura nga një numër më i madh biznesesh (si rezultat i rritjes së numrit të bizneseve të regjistruar dhe përfshirjes së subjekteve të katër njësive administrative) të ardhurat e mbledhura nga agjenti tatimor nuk arrijnë dot të ardhurat kur ky tatim administrohej nga strukturat e bashkisë. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.

Grafikisht paraqesim të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël si dhe nga taksa vendore mbi biznesi i vogël (në kohën kjo taksë ekzistonte).

Ecuria në vite e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël



Grafiku nr.1



BASHKIA BERAT

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura

Vitet	Fakt 2016	Fakt 2017	Plani 2018	Fakti 10 Mujori - 2018
Taksa e mjeteve te perdorura	19,794	19,178	27,032	21,760

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa e kalimit te drejtes se pronesisë per pasurine e paluajtshme

Vitet	Fakt 2016	Fakt 2017	Plani 2018	Fakti 10 Mujori - 2018
Takse e kalimit te se drejtes se pronesisë	2,250	2,478	3,200	1,729

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore në /000 lekë

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë, taksa mbi ndërtesat, mbi truallin, Takse e tabelës, Takse fjetje ne hotel, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike, taksa mbi token bujqesore. Efekt në pozitiv ka dhe taksa e ndërtesës për qëllime banimi, dhe kjo si rezultat i faturimit së bashku me faturën e ujit të pijshëm.

Vitet	Fakt 2016	Fakt 2017	Plani 2018	Fakti 10 Mujori - 2018
Taksat vendore	97,161	124,101	100,229	76,419

Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore në /000 lekë

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

Vitet	Fakt 2016	Fakt 2017	Plani 2018	Fakti 10 Mujori - 2018
Tarifat vendore	103,700	114,008	124,394	95,725




BASHKIA BERAT

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndricimit, gjelbërimit që mbledhen nga biznesi dhe nga familjet

Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel shumë të mirë realizimi.

Përvec realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.

Grafiku nr.3



➤ **NDRYSHIMET LIGJORE**

Gjithashtu një faktor tjetër në planifikim ndikojnë dhe ndryshimet ligjore në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ku taksa mbi ndërtesat dhe tabelat për qëllime identifikimi dhe reklamimi.

Nga ndryshimi i këtij ligji efekti nga taksa mbi ndërtesat për qëllime biznesi është 24,303,000 lekë, pra në planifikim janë më pak nga planifikimi i vitit 2018.

Efekt ka dhe taksa mbi tabelat ku efekti është 5,996,000 lekë, pra në planifikim janë më pak nga planifikimi i vitit 2018.



BASHKIA BERAT

Mbeshtetur ne ligjin 140/2016 për disa ndryshime në ligjin nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë ku aktiviteti i lojrave të fatit do të mbyllet duke filluar nga data 01.01.2019, ku në Njësinë Administrative Berat kanë ushtruar aktivitetin e tyre 93 subjekte. Për tarifën e pastrimit ka efekt 3,720,000 lekë, ndricim 558,000 lekë, gjelbërim 325,500 lekë. Kjo jep një efekt prej 4,603,500 lekë më pak në planifikimin e tarifave të vitit 2019.

- **Pra ne vitin 2019 do të jenë 34,902,500 lekë më pak në planifikim kundrejt vitit 2018.**

Këto ndryshime ligjore kanë dhënë një efekt negativ në planifikim dhe në të ardhurat e Bashkisë Berat.

LEHTËSIRAT TATIMORE

1. Për Bizneset e hapura, nga familjet e reja,dhe te drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarifë paguhet ne 20% me ulët te tarifës normale.Për Familjet me një prind, me fëmijë deri në moshën 22 vjec,që janë në vazhdimësi të arsimimit, per të gjitha Njësitë Administrative, kjo tarife paguhet në 30% me ulët të tarifës normale.

2.Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

Taksapaguesit, për kategorinë **I “Ndërtesa banimi”** dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës” si dhe të sëmurë para dhe tetraplegjikë.

Kjo zbatohet kur taksapaguesi nuk merret me aktivitet biznesi.

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;

c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;

d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa



BASHKIA BERAT

sociale;

dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;

ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;

f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore

3. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi tokën bujqësore :

a. Taksapaguesit që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës” si dhe të sëmurë para dhe tetraplegjikë.

Kjo zbatohet kur taksapaguesi nuk merret me aktivitet biznesi.

4. Taksa mbi truallin

Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi truallin taksapaguesit që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës” si dhe të sëmurë para dhe tetraplegjikë.

Kjo zbatohet kur taksapaguesi nuk merret me aktivitet biznesi

5. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifëpaguesit e kategorisë I “Familiarët” dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë, paguajnë 50 % të tarifës normale të pastrimit dhe largimit të mbeturinave.



BASHKIA BERAT

Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.

6. Tarifa e Ndrëçimit

Tarifëpaguesit e kategorisë I “Familiarët” dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë, paguajnë 50 % të tarifës normale të ndrëçimit publik.

Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.

7. Tarifa e Gjëlberimit

Tarifëpaguesit e kategorisë I “Familiarët” dhe që i përkasin kategorive me status “Invalid të punës dhe të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë” si dhe familjet me një pjestarë, paguajnë 50 % të tarifës normale të gjëlberimit publik.

Kjo zbatohet kur asnjë person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi

Në pasqyrat e mëposhtme paraqitet analitikisht planifikimi e çdo takse dhe tarife vendore për vitin 2019.

Pasqyra përmbledhëse e planit të të ardhurave të vitit 2019 të Bashkisë Berat ne 000/leke		
Nr	Emertimi	Plani 2019
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	3,000
II	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	4,510
III	Taksat vendore	136,393
1	Takse tabele	3,312
•	Tabelë për qëllime identifikimi	2,188
•	Tabelë për qëllime reklamimi	1,124
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	2,045
4	Takse fjetje në hotel	4,781
5	Takse mbi token bujqesore	24,641
6	Takse e mjeteve të përdorura	27,391
7	Takse e kalimit të drejtës së pronës (ZRPP)	3,297
8	Takse mbi ndertesat	61,126
•	Biznes	23,923
•	Familje	37,203
9	Takse trualli	9,799



BASHKIA BERAT

•	Biznes	8,475
•	Familje	1,324
IV	Tarifat vendore	119,810
1	Tarife e pastrimit	75,032
•	Biznes	47,152
•	Familje	26,455
•	Institucione	1,425
2	Tarife e ndriçimit publik	28,271
•	Biznes	10,188
•	Familje	17,911
•	Institucione	172
3	Tarife gjelberimi publik	14,746
•	Biznes	6,758
•	Familje	7,902
•	Institucione	86
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,751
5	Tarife e sherbimit administrativ	-
6	Tarife therje	-
7	Te tjera tarifa	10
VII	Te ardhura te tjera	19,940
•	Te ardhura nga qerate	-
2	Te ardhura nga parkimi	3,025
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	380
4	Te tjera debitore dhe gjyqe	16,535
TOTALI		283,653



BASHKIA BERAT

PLANI I TE ARDHURAVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE BERAT ne 000/leke		
Nr	Emertimi	Plani 2019
I	Taksat vendore	63,086
1	Takse tabele	2,847
•	Tabelë për qëllime identifikimi	2,173
•	Tabelë për qëllime reklamimi	674
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	1,790
4	Takse fjetje ne hotel	4,338
5	Takse mbi token bujqesore	1,023
6	Takse e mjeteve te perdorura	-
7	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise	-
8	Takse mbi ndertesat	47,128
•	Biznes	18,971
•	Familje	28,158
9	Takse trualli	5,960
•	Biznes	5,816
•	Familje	144
II	Tarifat vendore	102,111
1	Tarife e pastrimit	60,824
•	Biznes	41,543
•	Familje	17,856
•	Institucione	1,425
2	Tarife e ndriçimit publik	26,596
•	Biznes	9,942
•	Familje	16,482
•	Institucione	172
3	Tarife gjelberimi publik	13,031
•	Biznes	6,077
•	Familje	6,868
•	Institucione	86
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,660
5	Tarife e sherbimit administrativ	-
IV	Te ardhura te tjera	16,846
1	Te ardhura nga parkimi	2,846
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	-
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	14,000



BASHKIA BERAT

TOTALI	182,043
---------------	----------------

2.7 Planifikimi I te ardhurave nga drejtorite dhe institucionet e bashkise:

Drejtoria e Transporti Emergjencave civile dhe pronave.

Te ardhurat nga pronesia :

Objektivi: Rritja e te ardhurave te bashkisë nëpërmjet një menaxhimit sa më të mirë të pronave të bashkisë, rritjen e numrit te pronave të regjistruara ne Z.R.P.P, me qëllim rritjes se numrit të ambjenteve të dhëna me qira ose kontrata të tjera si dhe monitorim sa më efikas i tyre.

Të ardhurat **nga banesat sociale** për vitin 2019 ne shumën **3,986,088 lekë**

- 46 apartamente me strukture 1+1 x 6,994 leke/muaj= 321,724 lekë/muaj
- 2 apartamente me strukture garsoniere x 5,225 leke/muaj= 10,450 lekë/muaj

Shuma totale e te ardhurave 332,174 lekë/muaj x12 = **3,986,088 lekë**

Të ardhurate parashikuara nga 8 apartamente e Entit për vitin 2019 ne shumën **308,820 lekë**

Transporti:

- **Objektivi** : Administrimi i transportit duke synuar nje përjasje te integruar ne zhvillimin dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve , në mbrojtje të ambientit, një transporti i qëndrueshëm, i besueshëm dhe me mjete që duhet të përmiresohen duke ju përafuar standarteve të Komunitetit European .

Në mbështetje të ligjit nr. 10,date 11.02.2016, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 8308, date 18.03.1998 “Per transportet rrugore”, neni 3,neni 4 pika “ç”,neni 6,neni 10,ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

VKM nr.325,datë 19.03.2008 “Mbi rregullat për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve ,si dhe njohja e dokumentave zyrtare të caktuara për këta operatorë”

Lejet e transportit jane dhene per nje periudhe 5-10 vjecare . Per kete aresye edhe te ardhurat jane jo shume te konsiderueshme .

Parashikojme qe per vitin 2019 te ardhurat per Licence taxi 4+1 , Liber udhetimi , Certificate per te trete e me qera , autorizime etj te **jene 280 000 leke**

TE ARDHURAT NGA TREGU INDUSTRIAL I LAGJES “ 30 Vjetori ” per vitin 2019 , do te jenë përkatësisht 10,320,000 lekë,:



BASHKIA BERAT

- Parashikohen të jenë aktive mesatarisht 200 njësi / muaj, (gjithesej 304 njësi të tregut Industrial) .

te ndara sipas siperfaqes të dyqaneve ku:

- 110 njësi ,sip 5.5 m² x 4,290 lekë/ muaj= 471,900 lekë
- 28 njësi , sip 8.3 m² x 6,474 lekë/ muaj= 181,272 lekë
- 45 njësi ,sip 5.5 m² x 3,003 lekë/ muaj = 135,135 lekë(Është bërë ulje me vkb , për shkak të pozicionit ,jo të favorshëm).
- 12 njësi ,sip 5.5 m² x 2,000 lekë/ muaj = 24,000 lekë(Është bërë ulje me vkb , për shkak të pozicionit ,jo të favorshëm).
- 2 njësi ,sip 3.7 m² x 2,885 lekë/ muaj= 5,770 lekë
- 2 njësi (ish lokali dhe fast-foodi),sip 35 m² x 20,000 lekë/ muaj= 40,000 lekë
- 1 njësi ,sip 8.3 m² x 5,500 lekë/ muaj = 5,500 lekë(Është bërë ulje me vkb , për shkak të pozicionit ,jo të favorshëm).
- Shuma totale e te ardhurave në muaj , mesatarisht 860,000 lekë.

- Te ardhurat nga dhënia me qira e pronave ne Bashkinë Berat

Për vitin 2019 do të jetë **17, 998 121 lekë** nga të cilat

Berati: **9,900,000** lekë

Kompania “Shell” Albania 7,254,569 leke

Nga Njesite te ardhurat jane si me poshte :

Njësia Administrative Sinjë 31,000 lekë

Njësia Administrative Roshnik 301,000 lekë

Njësia Administrative Velabisht 526,000 lekë

Tabela e qirave per periudhen 2019

Nr	Institucioni Qiradhënës	Qiramarrësi	Vendndodhja	Sip. e dhënë me qira	Detyrimi mujor në lekë	Detyrimi 12mujorit në lekë
1	Bashkia Berat	Posta Shqiptare	Uznov	16 m ²	3480	41760
2	Bashkia Berat	"Shpresa" shpk	Konvikti Kristo Isak	113 m ²	22600	271200
3	Bashkia Berat	Raiffeisen Bank	Desmoret e Kombit	5 m ²	7000	84,000
4	Bashkia Berat	Ylli Toska	Uznov	10m ²	1000	12,000
5	Bashkia Berat	Shoqata Egjyptiane	Ish MCR	10m ²	1000	12,000
6	Bashkia Berat	Ramadan Eski	Stadiumi “Tomori”	40 m ²	6300	75,600
7	Bashkia Berat	Osumi Travel	Ish Parku I Udhëtarëve	55.6 m ²	25000	300000



BASHKIA BERAT

8	Bashkia Berat	Tatjana Toska	Ish Ndërmarrja e Gjellbërimit	(32.76 + 289) m ² nd+tru	9056	108,672
9	Bashkia Berat	Rexhep Arëza	Stadiumi "Tomori"	90 m ²	9000	108,000
10	Bashkia Berat	Gani Lacaj	Stadiumi "Tomori"	11 m ²	1100	13,200
11	Bashkia Berat	Qendra e Gruas	Pallati I Kulturës	44 m ²	6600	79,200
12	Bashkia Berat	Kontrat huapërdorje "Kristo Isak"	Stilano Bandilli	163m ² + 360 m ² +141m ²	0	-
13	Bashkia Berat	Kontrat shkëmbimi	Bashkia e vjetër	112 m ²	0	-
14	Bashkia Berat	Sh.a ujësjetelës kanalizime	Ish Parku I Udhëtarëve	107 m ²	32100	385,200
15	Bashkia Berat	Kontrat enfitëoze "Berat Trade" Shpk	Ish Markata	920 m ² + 946 m ²	373860	4,486,320
16	Bashkia Berat	Kontrat enfitëoze "Gega" shpk	Ish Konvikti I vajzave	1045 m ² + 425 m ² truall	310000	3,720,000
17	Bashkia Berat	Lokali Bashki	Bashkia E Re	157 m ²	15700	188,400
Total						9,885,552

shell 2018

Numër rendor	Emërtimi i subjektit	Sip .e objektit (m ²)	Masa e qirasë vjetore (lekë)
1	Shell Galinë	2000 m ²	256,278
2	Shell Velabisht	44 m ²	5,638
3	Shell Mbreshtan 1	4161 m ²	533,186
4	Shell Mbreshtan	120 m ²	15,377
5	Shell 3 Galinë	29200 m ²	3,741,659
6	Shell Mbreshtan 2	1210 m ²	155,048
7	Shell Molisht	19300 m ²	2,473,083
8	Shell Mbreshtan 3	580 m ²	74,300
Totali			7,254,569



BASHKIA BERAT

Ne lidhjen me dheniet me kontrate qiraje , te fondit pyjor dhe kullusor publik per ushtrimin e veprimtarive per nxjerrje , prodhim dhe depozitim materiale inerte ,direct nga siperfaqja (karriere), edhe ne kete Plan buxhet jemi mbështetur ne PBA perfundimtare 2018-2020, miratuar VKB nr.98 dt.15.12.2017, VKB ne muajin qershor miratoi draftin e pare te PBA 2019-2021, dhe PBA e rishikuar 2019-2021 te miratuar ne shtator 2018 me VKB. Ne keto kushte pavaresisht realizimit rreth 20 milion lek si 10 mujor , I qendrojme planifikimit afatm esem 2019-2021, me argumentimin: Ne lidhje me tarifen dysHEME per dhenien me kontrate qiraje , te fondit pyjor dhe kullusor publik per ushtrimin e veprimtarive per nxjerrje , prodhim dhe depozitim materiale inerte ,direct nga siperfaqja (karriere), VKM nr.391, dt.21.6.2006 , e ndryshuar me VKM nr.1064 dt. 22.12.2010, parashikon Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë). Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit

1 vit 1 Inproduktive 540 000 lek , per vit 2-5 vje, 495 000 leke/ha/vit, 6-10 vjet 440 000 lek/ha/vit.

Mbi bazen e ketij vendimi prej mujit nentor 2016 , nga bashkia jane bere ne menyre te vazhdueshme shkresa , drejtuar subjekteve te pajisur me leje shfrytezimi nga METE , per te lidhur kontrate qiraje me bashkine ne cilesine e pronarit per siperfaqen qe ato shfrytezojne , si dhe ju jane derguar faturat per arketim te detyrimit te llogaritur ne baze te VKM se sipercitur. Gjithashtu me urdher te kryetarit te bashkise nr.858, date 30.11.2017 eshte urdheruar bllokimi i aktiviteteve te ketyre subjekteve .

Nga ana e subjekteve nuk eshte bere asnje pagese ,por jane kundërshtuar ne menyre verbale apo me shkrim ,me pretendimin se nuk eshte kompetence e bashkise. Ne nje rast fatura per arketim eshte kundërshtuar ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Vlore , nga subjekti "B&B STONE" , ne perfundim gjykata ka vendosur "Konstatimin absolutisht te pavlefshem te shkreses me nr. 5139/3 dt.11.12.2017 "Dergim fature per arketim , ne zbatim te VKM nr.1064 dt. 22.12.2010" . Ky vendim eshte ankimuar nga bashkia ne gjykatën e apelit.

Nga ana tjeter bashkia ka kerkuar prane Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Berat , detyrimin e subjektit "Peglio Riçerca e Svilupo",per te paguar shperblimin e qirase mujore te papagur qe prej dates 01.07.2016 e ne vazhdim. Çështja eshte ne gjykim ne shkalle te pare .

Gjithashtu ne ligjin 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" në nenin 15, pika 5 shprehet: "5. me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, zëri "Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore", dhe regjistrohet në zërin "Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare", sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin." Pavaresisht nga parashikimi i ligjit te mesiper



BASHKIA BERAT

, sipërfaqet që shfrytezohen nga subjektet private deri tani nuk janë hequr nga fondi pyjor /kullësor me VKM.

Te ardhurat që krijohen nga kuota e ushqimeve të fëmijëve në kopesht e çerdhet janë përlogaritur në bazë të nr. mesatar të fëmijëve frekuentues, nr. mesatar të ditëve të frekuentuara dhe kuotën e miratuar.

Te ardhurat nga ndikimi në infrastrukturë për ndërtimet e reja janë planifikuar mbi bazën e tre viteve: Fakti 2016, fakti 2017, Plani 2018 dhe parashikimin e kërkesave për leje ndërtimi.

Drejtoria e Bujqësisë ka planifikuar të ardhurat nga shitja e druve, e cila është bërë në bazë të çmimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak 33 DT 30.03.2017. 2500 lekë/ mst.

2500 lekë/mst, të ardhura nga tjerja e bagetive pas leshimit të rrorit veterinar dhe të ardhura nga shërbime të tjera administrative, duke u bazuar tek fakti I viteit të mëparshëm dhe rritja e shërbimeve në këtë drejtori:

Të ardhurat nga taksat dhe tarifët si dhe të tjera të ardhura janë planifikuar nga secila Drejtori përgjegjëse, dhe konkretisht:

1. Drejtoria e Taksave për: takse fjetje në hotel, tarifë rregjistrim biznesi, të ardhura nga gjopa kamat vonesa, sipas të dhënave faktike për bizneset plus planin duke marrë parasysh realizimin e viteve të fundit.

2. Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit Territorit për: takse ndikimi në infrastrukturë dhe tarifë urbanistike, e planifikuar sipas trendit të realizimit të dy viteve të fundit, duke marrë parasysh dhe favorizimi nga ana e qeverisë për lejet e ndërtimit.

3. Drejtoria e Transportit, Emergjencave dhe Shërbimeve sektori : Manaxhimit të Pronave dhe Strehimit, përgjegjëse për planifikimin e të ardhurave nga qeratë, duke marrë parasysh kontrata qeraje ndërtese, toke bujqësore, truall, kullota dhe pyje

Ndërsa në zërin Të tjere Debitorë gjyqë janë planifikuar gjocat që priten të arkëtohen nga IMT, të cilat janë dhe në procese gjyqësore, e konfirmuar vetëm për gjocat e periudhës 2 vjeçare, pasi në periudhë me të gjatë, ato parashkruhen.

Në kapitujt pasues paraqitet Parqyra përmbledhëse e të ardhurave totale të bashkisë për periudhën afatmesme 2019-2020, përlogaritjet e të ardhurave për njesitë administrative.



BASHKIA BERAT

3. PLANIFIKIMI SHPENZIMEVE TE BASHKISE BERAT PER VITIN 2019

3.1 STRUKTURA FINANCIARE E BUXHETIT PER VITIN 2019

PLAN BUXHETI 2018 :

Bashkia Berat miratoi buxhetin e vitit 2018 me VKB nr.98 date 15.12.2017 dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr. 2052/1 date 22.12.2017, i cili me pas u dergua per celje prane deges se thesarit brenda afatit ligjor .

Me VKB nr. 16 date 16.02.2018 konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr 468/1 date 20.02.2018, u miratua shtesa e buxhetit te bashkise per te ardhurat e trasheguara nga viti 2017 ne vitin 2018, buxhet i cili u be efektiv prane deges se thesarit Berat.

Ndryshimet e buxhetit gjate 4- mujorit te dyte (maj-gusht 2018), u vendimuan ne Keshillin Bashkiak me VKB nr.87 date 26. 07.2018 , konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr 2121/1 date 30.07.2018. Mbi bazen e ketij Vendimi plani i te ardhurave te bashkise u rit me 22 346 000 leke (te ardhura nga qerate e banesave sociale si dhe te ardhura nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi).

- Total plani i te ardhura shkon ne 505 071 000 leke,

Bashkia Berat planifikon ne fillim te vitit 2018, një buxhet prej 1010.1 milionë lekë nga të cilat :

- | | |
|--|--------------------|
| 1. Transferta e pakushtëzuar | 277.1 milionë lekë |
| 2. Transferta specifike për funksionet e deleguara | 250.3 milionë lekë |
| 3. Të ardhurat lokale planifikuar për vitin 2018 | 482.7 milionë lekë |

Buxheti i vete bashkise eshte 759.8 milion leke ,10.8% me i larte se buxheti i vet bashkise ne vitin 2017.

Total buxheti i vitit **2018 eshte 11.2% me** shume se ai i vitit 2017, ne vlere absolute rritja prej 102.3 milion leke.

Total buxheti I korrigjuar I bashkise Berat per vitin 2018 behet 1 164 990 leke.

Bashkia Berat planifikon nje buxhet total prej **1 036 051 lekë ose 2,6 %** me i larte se ai i vitit 2018, (Buxheti fillestar). nga të cilat :

- 48% te totalit te buxhetit e zene shpenimet e peronelit,
- 26% shpenzimet operative dhe te mirembajtjes ,
- 26% shpenzimet per investime.



BASHKIA BERAT

PLAN BUXHETI I VITIT 2019

Plan buxheti I vitit 2019 eshte i balancuar. Ne mbeshtetje te Udhezimit te Ministrit te Financave nr.2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, buxheti vendor eshte unik, te ardhurat dhe shpenzimet parashikohem per cdo ze te tyre, pavaresisht nga burimet e financimit. Struktura e tij eshte e plote, per te gjithë elementet, si ne krahun e te ardhurave dhe ne ate te shpenzimeve.

Mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme, ky buxhet eshte i detajuar deri ne llogarite analitike, per cdo ze te ardhure dhe cdo ze shpenzimi.

Plan Buxheti i vitit 2019 perbehet nga:

Ne 000/leke

A - Te ardhurat gjithsej (I +II).....1 036 051

I - Te ardhurat e buxhetit te pavarur.....498 966

- Te ardhurat Lokale (Plan i vitit 2019).....498 966

II - Transferta gjithsej.....537 085

Transferta e pa kushtezuar285 474

- Transferta sektoriale.....251 611

- B - Shpenzimet gjithsej.....1 036 051

I-Shpenzime korrente nga Burime e veta.....493 440

I-Shpenzimet sektoriale251 611

III - Investime gjithsej (Teprica neto operative)....269.100

Nga te ardhurat e Bashkise269.100



BASHKIA BERAT

PASQYRE E PESHES SPECIFINE E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE NE BUXHETIT E VITIT 2019/KUNDREJT BUXHETIT 2018.

000/leke

Nr.	Pershkrimi	Viti 2018	Pesha Specif. %	Viti 2019	Pesha Specif. %
I	Totali i te ardhurave	1010163	100	1,036,051	100
1	Total Transferta	527438	52	537,085	52
a	Transferta e pakushtezuar	277104	27	285,474	28
b	Transferta e pakushtezuar trashëguar nga viti paraardhës		0	0	0
c	Transferta Specifike	250334	25	25,1611	24
d	Transferta e Specifike trashëguar nga viti paraardhës			0	0
2	Total te ardhura te veta	482725	48		48
a	Te ardhura te veta	482725	48	498,966	48
b	Te ardhura te veta trashëguar nga viti paraardhës	0	2	0	0
II	Totali i Shpenzimeve	1010163	100	1,036,051	100
1	Totali shpenzime operative	772743	76	766,951	76
a	Shpenzime personeli	482096	47	499,150	48
b	Shpenzime operative, & mirembajtjes & te tjera transfert	290647	29	267,801	26
2	Shpenzime kapitale	237420	24	269100	26


Disa tregues te total Buxhetit 2019 /krahasimi me buxhetin 2018:

1. Te ardhurat e vete perbejne **48 %** te totalit te Buxhetit te Bashkise Berat, po kaq sa ne vitin 2018,
2. Transferta e pakushtezuar perben **28 %** te totalit te Buxhetit te Bashkise Berat, kundrejt 27% ne vitin 2018..
3. Transferta specifike perben **24 %** te totalit te Buxhetit te Bashkise Berat, kundrejt 25% ne vitin 2018..
4. Shpenzimet e personelit perbejne **48 %** te totalit te shpenzimeve te Bashkise Berat, kundrejt 47% ne vitin 2018.
5. Shpenzimet operative & te mirembajtjes dhe te tjera transfert perbejne **26 %** te totalit te shpenzimeve te Bashkise Berat, kundrejt 29 % ne vitin 2018..
6. Shpenzimet per investime perbejne **26 %** te totalit te Buxhetit te Bashkise Berat, kundrejt 24% ne vitin 2018..




BASHKIA BERAT

Struktura e financimeve per vitin 2019



Struktura e shpenzimeve per vitin 2019





BASHKIA BERAT

3.2 PLANIFIKIMI SHPENZIMEVE SIPAS NDARJES EKONOMIKE VITI 2019

Shpenzimet ne total te vitit 2019 prej 1 036 051 000 leke përbëhen nga:

- Shpenzimet korrente** (paga, sigurime dhe shpenzimet operative të administrates dhe te Njësive Shpenzuese), ne Shumen 766 951 000 leke, ose krahasuar me vitin 2018 qe u planifikuan , 772748 000 leke, ose 0.7 % . me pak.
- Shpenzimet kapitale** jan planifikuar ne shumen 269 100 000 leke, kundrejt 237 420 000 leke ne vitin 2018, ose 13.3% me shume, ne vlere absolute rritja eshte 31 680 000 leke.

3.2 A. Planifikimi Shpenzimeve korrente

A Planifikimi i nr.te punonjesve dhe shpenzimeve te personelit (paga dhe sigurime shoqërore).

Për vitin 2018 numri maksimal i punonjesve ishte 699 , gjate vitit u miratua shtesa e punonjesve prej 5 rojesh sezonal per pyllin me pisha.

Për vitin 2019 numri maksimal i punonjesve ishte 699 , gjate vitit u miratua shtesa e punonjesve prej 5 rojesh sezonal per pyllin me pisha.

Ne pasqyren e meposhtme paraqitete numri i punonjësve të Bashkise Berat sipas njesive shpenzuese dhe burimeve te financimit:

Nr	Emërtimi Njesia Shpenzuese	Viti 2018	Viti 2019	Fondet e Bashkisë	Transferta sektorale
1	Aparati i Bashkisë	134	118	118	
2	Policia Bashkiake	11	11	11	
3	IMT	3	3	3	
4	MZSH	37	37	6	31
5	Drejtoria Arsimit Bashkia Berat - Administrata 44 - Çerdhet 38 - Konviktet 14 - Arsimi parashkollor(kopshtet e fëmijëve) edukatore dhe punonjës ne QKF 114 - Punonjësit e shërbimeve mbështetëse ne arsimin bazë, arsimin 9 vjeçar	310	310	82	228



BASHKIA BERAT

	(Parashkollori+ QKF) 80 - Punonjësit e shërbimeve mbështetëse ne Arsimin mesëm (Roje,sanitare dhe sekretare) 20				
6	Ndërrmarja e Shërbimeve Publike	65	79	75	4
7	Ndërrmarja e Gjelberimit	58	58	58	
8	Drejtoria e Bujqësisë,Administrimit të Pyjeve,Ujrave dhe Veterinarisë	32+5 punonjes sezonale	32	22	10
9	- Qendra Kulturore 26 - Shumësportet 2	27	28	28	
10	Qendra “Lira”	22	23		23
	Totali	699+5	699	403	296

Me fonde te deleguara (Qe nuk perfshihen ne nr e pergjithshem te punonjesve) jane :

Gjendja civile 10 punonjes

Q.K.B 3 punonjes

Bashkia Berat planifikon 499 150 000 leke shpenzime personeli, kundrejt pritshmerise realizimit te ketij zeri ne vitin 2018 ne shumen 482 096 000, me rreth 1 % rritje, Perlllogatirja e pagave eshte bere ne vijim te zbatimit te VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativ të njësive të qeverisjes vendore “ ndryshuar me VKM nr. 177 datë 8.03.2017.

Shpenzimet e personelit (600+601), ne PBA 2019-2021 mbeshtet ne nr, e pandyshuar te punonjesve per tre vitet ne vijim si dhe ne kuadrin ligjor ne fuqi perperlllogaritjen e pagave ne zbatim te Vendimit te Keshillit Bashkiak nr. 24 date 30.03.2017 “Mbi miratimin e nivelit te pagave te punonjësve te bashkise, njësive vartëse dhe shpërblimin e kryetareve te fshatrave”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me nr. 455/1 prot. date 07.04.2017 “Për verifikim te ligjshmërisë se akteve”, dhe VKB nr.42 date 28.04.2017.VKB n r.57 date 31.05.2017, dhe VKB nr, 31.01.2018.

Keto shpenzime do te zene rreth 48% e totalit te shpenzimeve vjetore, duke ruajtur te njejtin trend rrites rreth 3%, per vitete pauses.




BASHKIA BERAT

PASQYRA :Dinamika e shpenzimeve per paga dhe sigurime shoqerore ne vite

000/lek

Fakt 2016	Fakt 2017	Plan 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
368 466	434 642	490 970	499 150	512 787	526 784



3.3 Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike vendore.

Shpenzimet operative dhe te mirembajtjes. Bashkia Berat planifikon per vitin 2019 shumen prej 267 801 000 leke shpenzime operative dhe te mirembajtjes , kundrejt 280 175 000 leke pritshmeria e realizimit te ketij zeri 2018, ulja prej 4.4%, ka te bej me ulen e shpenzimeve administrative , pa cenuar anje sherbim publik.

Ne vitin 2017 u realizuar 230 812 000 leke ne kete grup shpenzimi. Ne vitin 2016 fakti I realizimit te ketij grup shpenzimi ishte ne Shumen 186 578 000 leke. Ky grup shpenzimi ka trend rritesh me synimin e permiresimit te cilesise se sherbimeve publike vendore , administrimit dhe mirembajtjes me te mire te ambjenteve mesimore , infrastruktures rrugore, mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta, permiresisit te ndicimit public etj.




BASHKIA BERAT

Parashikohet te zene rreth 26% te totalit te shpenzimeve vjetore, duke ruajtur trendin rrites nga njeri vit ne tjetrin.

SHPENZIMET OPERATIVE, TË MIRËMBAJTJES DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE NE DINAMIKE.

000/leke

Fakt 2016	Fakt 2017	Plan 2018	parashikimi 2019	Parashikimi 2020	parashikimi 2021
220206	230 812	280 175	267 801	289 358	526 784



Ne kapitujt pauses jepen argumeta te plote ne llogaritjen dhe planifikimin e artikujve dhe nenartikujve te shpenzimeve operative, sipas programeve dhe njesive shpenzuese.

Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja.

Projekti: “Ndërtimin e Banesave me Qëllim Social”, shuma e disburësuar e kredise eshte 587,707 Euro.

Në bazë të marrëveshjes të nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat , me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.12 datë 18.03.2011 “Mbi miratimin e mases se qerase se banesave me qellim social si dhe hapjen e nje llogarie te vecante ne nje banke te nivelit te dyte”, mbeshetur ne VKM nr. 260 date 24.02.2010 “Per metodiken e llogaritjes se mases se qerase , kur banesat sociale financohen nga buxheti I shtetit, ose i bashkive apo nga kombinimi i te dyjave” .



BASHKIA BERAT

Ne kete marreveshje jane percaktuar kestet e shlyerjes se principalit sipas viteve. Bashkia Berat i ka respektur me korrektesi afatet dhe shumat perkatese.

- Shlyerja e kredise ka filluar më date 19.12.2014 në vlerën 18,700 €
- Në vitin 2015 në vlerën 45,700 € nga të cilat 27,000 € nga fondi i bashkisë dhe 18,700 € nga fondi i banesave sociale.
- Ne vitin 2016 kësti i shlyer ka qënë në vlerën 56,170.7 € i shlyer përkatësish nga fondi i bashkisë dhe 29,170.7 € nga fondi i banesave sociale 27,000 €
- Ne vitin 2017 kësti i shlyer është në vlerën 58,770.7 € i shlyer nga fondi i bashkisë dhe 31,770.7 € nga fondi i banesave sociale 27,000 € .

Ne total duke filluar që nga viti 2014 është paguar shuma prej 179,341.4 € nga të cilat 106,641€ e shlyer nga fondet e bashkise dhe 72,700 € e shlyer nga fondet e banesave sociale mbetet për tu shlyer shuma prej 408,365.6 €.

- Shlyerja e kestit te kredise për vitet 2018 , do te jete në vlerën **58,770, €** nga të cilat **31,770 €** do të shlyhet nga fondet e bashkisë dhe **27,000 €** do të shlyhen nga fondi i banesave sociale.

Shlyerja e kestit te kredise për vitet 2019 do te jete në vlerën **58,770,7 €** ose 7 522 650 leke.

.4 Shpenzimet për subvencione.

000/lek

Emertimi	F.2016	P.2017	P.2018	P.2019	P.2020	2021
Futbolli	30,000	33,000	27,000	26,000	27,000	27000
Bonus Strehimi	1,130	1,200	1,200	1,200	1,300	1300

.5 Transferta tek organizatat dhe individë.

Ne transfertat qe bashkia Berat, do te kryej per vitin 2018 dhe dy vitet pasues, mbeshetur ne pervojen e viteve te meparshme do te jene:

1. Transferte Keshillit te Qarkut (Kuote) sipas ligjit 68/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, neni 38 pika 3.
2. Detyrim kontraktual Ndermarrjes Ujesjelles-kanalizime ne rolin e agentit tatimor, per sherbimin qe kryen per mbedhjen e tarifave vendore te pastrimit, gjelberimit dhe ndicimit nepermjet fatures mujore te ujit.
3. Transferimi i tarifave vendore qe paguan biznesi i zones BID (Pedonalja)
4. Transferte Drejtorise Rajonale te Tatime per tatimin e thjeshtur (1 % mbi shumen e arketuar , percaktuar me ligj.)



BASHKIA BERAT

Transfertat	F. 2016	F. 2017	P. 2018	P.2019	2020	2021
Keshilli I Qarku	1,000,000	3,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1000 000
Detyrim kontraktual UKBK	659,100	403,125	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1000 000
Partneritet Shoqata BID	772,400	1,276,134	1340,000	1 340,000	1 340,000	1340 000
Transferte per DRT	75,035	36,000	500,000	500,000	500,000	500 000

.6 Fondi rezerve, Fondi i kontigjences, fondi i emergjencave civile.

- Bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 te ligjit nr. 9936, date 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, krijohet **Fondi Rezervë**.
- Per të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet **Fondi i Kontigjences**. Te dy këto fonde miratohen në masën deri ne **3 (tre) %** të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.
- **Fondet e Emergjences** planifikohen per te përballuar situata emergjente. Ne zbatim te nenit 16 te ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 “Per Emergjencat Civile ” te ndryshuar, te nenit 29 te ligjit nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, te pikes III/3 te VKM nr.329,date 16.05.2012, “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”
- Parashikimi i fondeve te emergjencave civile dhe fondit rezerve eshte mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme, ndersa fondi I kontigjence parashikohet per here te pare ne vitin 2017 dhe u perdor ne zbatim te VKB nr. 18 date 28.02.2017.

000/leke

Emertimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Fondi Rezerve	1,470	1,671	2,500	2,500	2,500	2,500
Fondi i Emergjences	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500
Fondi i Kontigjences	0	4.000	6,000	6,000	6,000	6,000
Totali	3,970	8,171	11,000	11,000	11,000	11,000



BASHKIA BERAT

7. Fondi I investimeve:

Planifikimi për investime (230, 231) nga fondet e bashkise.


Investimet ne total per njesite e qeverisjes vendore përballohen nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore, transferta e pakushtëzuar, nga buxheti i shtetit, nepermjet Fondit te Zhvillimit te Rajoneve si dhe donator dhe partner.

Ne terma real fondi I investimeve nga te ardhurat e bashkise ka trend rrites nga njeri vit ne tjetrin.

- i. Ne vitin 2014 (para reformes) u planifikua 78.2milion lek investime ose 17 % e buxhetit.
- ii. Ne vitin 2015 u planifikua 74.4 milion lek investime ose 17 % e buxhetit ,dhe u realizuan 63.7 milion leke.
- iii. Ne vitin 2016 u planifikua 173.2 milion lek investime ose 15 % e buxhetit, dhe u realizuan 131.2 milion leke.
- iv. Ne vitin 2017 u planifikua 235.4 milion lek investime ose 23 % e total buxhetit ose 32.2 % e buxhetit te vet bashkise (Grand + te ardhura).
- v. Ne vitin 2018 kemi planifikuar 237.4 milion lek investime ose 24 % e totalit te buxhetit ose 31.2% e buxhetit te vete bashkise,(Grand + te ardhura).
- vi. **Ne vitin 2019** kemi planifikuar 269.1 milion leke ose 26% e totalit te buxhetit.

Ne terma real rritja eshte **190.9** milion leke, krahasuar me vitin 2014(Vitit para reformes).

Paraqitja grafike e dinamikës së fondeve të investimeve nga të ardhurat e bashkise





BASHKIA BERAT

Bashkia Berat planifikon për vitin 2019, 269 100 000 leke me të cilat do të përballohen:

- Investimet në proces nga viti 2018 dhe që kanë kontratë shtrirje në dy-tre vite.
 - Investime të reja të programuara në periudhën afatmesme 2019-2021.
- Hollësisht për çdo objekt dhe program kemi pasqyrën në fund të materialit.

PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE DHE PËRSHKRIMET E TYRE.

Ne zbatim të Udhezimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 23 datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të qeverisjes vendore", bashkia Berat, ka përgatitur Plan buxhetin 2019 dhe PBA perfundimtare 2019-2021, mbi bazën e 30 programeve buxhetore si më poshtë:

Nr.	Kodi	PËRSHKRIMI PROGRAMIT	Nr.	Kodi	PËRSHKRIMI PROGRAMIT
1	01110	Planifikim, menaxhim, administrim	16	05100	Menaxhimi i mbetjeve
2	01120	Çështje financiare dhe fiskale	17	05200	Menaxhimi i ujërave të zeza
3	01710	Pagesa e borxhit (kredia B.S)	18	06140	Planifikimi urban vendor
4	03140	Policia vendore	19	06260	Gjelbërimi
5	03280	Mbrojtje nga zjarri dhe shpëtim	20	06330	Furnizimi me ujë
6	03600	Marrdhënie me komunitetin	21	06440	Ndriçim rrugësh
7	04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	22	07220	Sherbimi shëndetësor (Pediatri)
8	04160	Sherbimi i tregjeve	23	08130	Sporti dhe kreativiteti
9	04220	Bujqësia dhe mbrojtja e konsumatorit	24	08220	Kultura dhe trashëgimia
10	04240	Ujitja dhe kullimi	25	09120	Arsimi bazë +parashkollor
11	04260	Pyje dhe kullota	26	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm
12	04520	Rrjeti rrugor rural	27	09240	Arsimi profesional
13	04570	Transporti publik	28	10140	Sëmundje dhe paafësi
14	04740	Projekte zhvillimi	29	10430	Familja dhe fëmijët
15	04760	Zhvillimi i turizmit	30	10661	Strehimi social

FUNKSIONI 1: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE

Nënfunkcioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislativë, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Emertimi i programit : Planifikim . menaxhim , administrin: Kodi i programit 01110.

Njësia shpenzuese: Bashkia Berat

Fondi planifikuar 112 984 000 leke ose 11% e totalit të shpenzimeve buxhetore.



BASHKIA BERAT

-shpenzime korrente 96 868 000 leke

-shpenzime kapitale 16 116 000 leke (lista e investimeve)

Nr. Punonjesve. 47

Veshtrim i përgjithshëm : Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;

Përshkrimi i programit

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
- Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, zyrave të printimit dhe IT etj.
- Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë.
- Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit;

Ky program parshikon manaxhimin financiar të Bashkisë Berat dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarrvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Objektivat e politikës së programit:

- a) Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në Bashki në mënyrë që të përgjigjen realizimit të vizionit dhe misionit të bashkisë dhe të përgjigjen standarteve më të larta që kerkohen në Qeverisjen Vendore.
- b) Nxitja e sigurimit të shërbimit cilësor dhe me efektivitet ndaj qytetarëve.
- c) Të ofroj një partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis palëve duke garantuar mbarrvajtje optimale të punës në shërbim të komunitetit.

Produktet që synohen të ofrohen.

- a. Plotësim i 100% me nëpunës e punonjës i strukture organizative të miratuar , në bazë të politikave të përcaktuara për rekrutim , seleksionim dhe emerimin e punonjësve civilë, si dhe marrjen në punë të nëpunësve dhe punonjësve të tjerë.
- b. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe shërbimit për qytetarët.
- c. Venia në efikasitet të plotë të Zyres me një ndalesë .
- d. Instalimi i sistemit të rrjeteve kompjuterike për administratën (përmirësim i sistemit të IT) .



BASHKIA BERAT

- e. Implementimi i sistemit PAV (platforma e administrates vendore) dhe krijimi i Regjistrat Qendror të personelit të administres vendore. (përfutjes të projektit tefinasncuar nga Fonde të Qeverise zvicerane, Keshilli i Europes.)

Aktivitetet që synohen të realizohen

- Realizimi i pageses se pagave dhe të sigurimeve shoqerore për nëpunësit dhe punonjësit e bashkisë.
- Plotesimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë.
- Sigurimi i materialeve dhe shërbimeve speciale.
- Realizimi i shërbimeve ndaj të tregëtisë.
- Realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Sigurimi i levizjes së nëpunësve dhe realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Mirëmbajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe vet ambienteve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të, mirëmbajtjes së zakonshme.
- Realizim i shpenzimeve për pritje përcjellje.
- Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

EMERTIMI I PROGRAMIT : ÇËSHTJE FINANCIARE DHE FISKALE kod 01120

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat . Drejtorite Financa, Taksat dhe Auditit.

Fondi planifikuar 24 908 000 leke. ose 2.4% e totalit të shpenzimeve

-Shpenzime korrente 24 908 000 leke

Nr. Punonjësve. 27

Politika e programit : Forcimi i financave vendore nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit fiskal në nivel vendor.

Zbatimi efikas i buxhetit dhe rritja e të ardhurave, duke formalizuar ekonominë nëpërmjet reduktimit të ekonomisë informale dhe rritjes së të ardhurave nga tatimet

Pershkrimi i programit:

- Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj.
- Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

Objektivat e politikës së programit:

- f. Shtrirja e Sistemit Informatik të Administrimit të Taksave (TAIS) edhe në njësitet administrative Roshnik, Sinje, Velabisht dhe Otlak. (për biznesit).



BASHKIA BERAT

- g. Permiresimi i sistemit te programit te administrimit te taksave vendore TAIS me element te tjere.
- h. Përmirësimi i produktivitetit, efektivitetit dhe efijencës së punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet dhe potencialin e tyre.
- i. Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime .

NËNFUNKSIONI 017: SHËRBIME TË HUAMARRJES VENDORE

EMERTIMI I PROGRAMI: PAGESA PËR SHËRBIMIN E BORXHIT TË BRENDSHËM, kodi 01710

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat . ose 1% e totalit te shpenzimeve.

Fondi planifikuar 8 413 000 leke.

- shpenzime korrente ----- leke

- shpenzime kapitale 8 413 000 leke

Nr. Punonjesve. 0

Ky nënfunkcion përfshin marrëdhënien e njësisë vendore me kreditorët dhe shërbimin e borxhit të brendshëm të njësisë vendore.

Pershkrimi i programit:

- Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore;
- Amortizimi i huave të marra etj.

Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja.

Projekti: “Ndërtimin e Banesave me Qëllim Social”, shuma e disburësuar e kredise eshte 587,707 Euro, ne bazë të marrëveshjes të nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat , me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.12 datë 18.03.2011 “Mbi miratimin e mases se qerese se banesave me qellim social si dhe hapjen e nje llogarie te vecante ne nje banke te nivelit te dyte”, mbeshtetur ne VKM nr. 260 date 24.02.2010 “Per metodiken e llogaritjes se mases se qerese , kur banesat sociale financohen nga buxheti I shtetit, ose i bashkive apo nga kombinimi i te dyjave” Ne kete marreveshje jane percaktuar kestet e shlyerjes se principalit sipas viteve. Bashkia Berat i ka respektur me korrektesi afatet dhe shumat perkatese.

- Shlyerja e kredise ka filluar më date 19.12.2014 në vlerën 18,700 €
- Në vitin 2015 në vlerën 45,700 € nga të cilat 27,000 € nga fondi i bashkisë dhe 18,700 € nga fondi i banesave sociale.



BASHKIA BERAT

- Ne vitin 2016 kësti i shlyer ka qënë në vlerën 56,170.7 € i shlyer përkatësish nga fondi i bashkisë dhe 29,170.7 € nga fondi i banesave sociale 27,000 €
- Ne vitin 2017 kësti i shlyer është në vlerën 58,770.7 € i shlyer nga fondi i bashkisë dhe 31,770.7 € nga fondi i banesave sociale 27,000 € .

Ne total duke filluar që nga viti 2014 është paguar shuma prej 179,341.4 € nga të cilat 106,641€ e shlyer nga fondet e bashkisë dhe 72,700 € e shlyer nga fondet e banesave sociale mbetet për tu shlyer shuma prej 408,365.6 €.

- Shlyerja e kestit te kredise për vitet 2018 , do te jete në vlerën **58,770, €** nga të cilat **31,770 €** do të shlyhet nga fondet e bashkisë dhe **27,000 €** do të shlyhen nga fondi i banesave sociale.

Shlyerja e kestit te kredise për vitet 2019 do te jete në vlerën **58,770,7 €** ose 7 522 650 leke.

FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE 03140

Nënfunkcioni 031: Shërbimet policore

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

EMERTIMI I PROGRAMI : Shërbimet e Policisë Vendore 03140

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 9 147 000 leke ose 1% e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente 8 447 000 leke

-shpenzime kapitale 700 000 leke (Blerje mjete per policine bashkiake)

Nr. Punonjesve. 11

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Politika e programit: Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe rritja e besimit të publikut, nëpërmjet uljes së në kohës së përgjigjes së policisë ndaj thirrjeve të komunitetit dhe rritjes të numrit të thirrjeve të publikut.

Pershkrimi i programit:

- Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;
- Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë;



BASHKIA BERAT

NËNFUNKSIONI 032: SHËRBIMET E MBROJTJES NGA ZJARRI

EMERTIMI I PROGRAMI Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 37 379 000 leke. ose 4% e totalit te shpenzimeve.

shpenzime korrente 34 179 000 leke

-shpenzime kapitale 2 200 000 leke (TVSH per mjetin qe do te blihet nga donator)

Nr. Punonjesve. 37

Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse;

Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Forcimi i uljes së riskut të fatkeqësive dhe menaxhimi i mbrojtjes civile nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të entiteteve të përgatitjes për emergjencë dhe reagimit ndaj fatkeqësive; mbledhjes dhe organizimit të informacionit për risqet dhe forcimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm;

Pershkrimi i programit:

- Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
- Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
- Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;

Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmytura etj.

EMERTIMI I PROGRAMI Marrëdhëniet në komunitet 03600

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 2 239 000 leke ose 0.2% e totalit te shpenzimeve..

shpenzime korrente 2 239 000 leke

-shpenzime kapitale 0

Nr. Punonjesve. 3

Masa të njësisë së vetëqeverisje vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësia vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

Pershkrimi i programit: Aktivitete të njësisë për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjelltë dhe ndjenjën e përkatësisë brenda njësisë, besimin dhe mbështetjen për autoritetet vendore;

- Rritja e pjesmarrjes aktive të qytetarëve në vendimarrje, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve për këtë qëllim



BASHKIA BERAT

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

Nënfunkcioni 041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

EMERTIMI I PROGRAMI : Mbështetja për zhvillim ekonomik 04130

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar	850 000	leke. ose 0.08% e totalit te shpenzimeve.
shpenzime korrente	-----	leke
-shpenzime kapitale	850 000	leke (lista e investimeve ne fq. te materialit)
Nr. Punonjesve.	-----	

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor. Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe punësimit në vend, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe përmirësimi i klimës së biznesit përmes dhënies dhe aksesit të lehtësuar të informacionit për të bërë biznes në Berat.

Pershkrimi i Programit.

- Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i **politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare** të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve; QKR
- Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik;
- Funksionimi ose mbështetja me politika vendore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë;
- Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ;
- Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj.
- Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj.

Objektivat e politikës së programit.

- Gjetja e menyrave me efikase për zgjerimin e bazës së taksueshme të bizneseve dhe të familjeve.
- Vlerësim sa më real i detyrimeve të taksapaguesve nga ana e administratës tatimore vendore.
- Ofrimi i një shërbimi me cilësor dhe brenda një kohe sa më të shkurtër, në sajë edhe të informatizimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.
- Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.



BASHKIA BERAT

- Asistence dhe keshillim nga administrata tatimore vendore per cdo biznes qe kryen aktivitet tregtar si dhe per cdo individ i cili deshiron te cele aktivitetet te ri tregtar.
- Përmirësimi i administrimit të të ardhurave vendore.
- Mbeshtetje , marketim, promovim dhe aftesim i biznesit lokal ne funksion te zhvillimit te ekonomise lokale.
- Mbeshtetje e biznesit per te diversifikuar aktivitetin e tij dhe nxitja e sipermarrësve te rinj me synim krijimin e nje ekonomie lokale te qendrueshme dhe konkurruese ne rajon.
- Promovimi dhe mbështetja e biznesit, hartimi i politikave për thithjen e biznesit te ri inovativ ne bashkine e Beratit me ane te lehtesimit te taksave dhe subvencioneve.

EMERTIMI I PROGRAMI Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi 04160
Njesia shpenzuese: Bashkia Berat ose 0.2% e totalit te shpenzimeve.

Fondi planifikuar 2 247 000 leke ose 0.2% e totalit te shpenzimeve.
shpenzime korrente 2 247 000 leke
-shpenzime kapitale -----

Nr. Punonjesve. 3

- Forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturave operacionale për kontrollin e produkteve të tregtuara
- Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve; Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.

Nen nfunkioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia

Njesia shpenzuese: Drejtoria e Bujqesise, Administrimit te Pyjeve,kullotave dhe Ujrave .

Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit.

EMERTIMI I PROGRAMI Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve 04220

Fondi planifikuar 17 145 000 leke, ose 2% e totalit te shpenzimeve.
shpenzime korrente 17 145 000 leke
-shpenzime kapitale -----

Nr. Punonjesve. 22

Pershkrimi programit:

- Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave;



BASHKIA BERAT

- Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore;
 - Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve;
 - Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë;
 - Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë;
 - Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural.
 - Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit.
- Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës;

EMERTIMI I PROGRAMI Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit 04240

Njesia shpenzuese: Drejtoria e Bujqesise, Administrimit te Pyjeve, kullotave dhe Ujrave .

Fondi planifikuar 14 250 000 leke. ose 1.4% e totalit te shpenzimeve.

shpenzime korrente 14 250 000 leke

-shpenzime kapitale

Nr. Punonjesve. 5

- **Pershkrimi programit:**
- Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla; Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

EMERTIMI I PROGRAMI Administrimi i pyjeve dhe kullotave 04260

Një menaxhimi më të mirë të pyjeve dhe ujërave dhe aplikimit të metodave të prodhimit bujqësor duke mbrojtur mjedisin dhe zbutjen e ndryshimeve klimaterike

Njesia shpenzuese: Drejtoria e Bujqesise, Administrimit te Pyjeve, kullotave dhe Ujrave .

Fondi planifikuar 5 151 000 leke. ose 0.5% e totalit te shpenzimeve.

shpenzime korrente 5 151 000 leke.

-shpenzime kapitale

Nr. Punonjesve. 5

- **Pershkrimi programit:**
- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
- Konservim, zgjerim dhe shfrytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;
- Administrim i fondit pyjor dhe kullosor publik;



BASHKIA BERAT

- Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh.
- Organizim ose mbështetje për veprimtarinë rryllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
- Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes;

Nënfunksioni 045: Transporti

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

EMERTIMI I PROGRAMI Rrjeti rrugor 04520

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat & Ndermarja e Shërbimeve Publike

Fondi planifikuar 184 220 000 leke. ose 18% e totalit të shpenzimeve.

shpenzime korrente 62 035 000 leke.

-shpenzime kapitale 122 185 000 leke ((lista e investimeve)

Nr. Punonjesve.75

Pershkrimi programit:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore;
Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;

Objektivat e Programit

- Zhvillimi i një sistemi efikas të transportit, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-se, që nxit zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetesës së qytetarit.
- Përmirësimin e rrjetit ekzistues të rrugëve të asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve.
- Rritja e sipërfaqeve të shtruara me kalldrem në masën 4.5 %, për vitin 2019 dhe progresivisht 2019-2021.
- Të mirëmbahen trotualet , kalldremet ekzistuese dhe të shtohen sipërfaqet e reja të tyre.



BASHKIA BERAT

Produktet qe synohen te ofrohen

1. Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.

Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës. Siperfaqja totale e rrugëve është 857 323 m² në të gjithë territorin e Bashkisë nga të cilat 239 231 m² janë të trajtuara me asfalt dhe 618 092 m² me stabilizant.

2. Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha, të larta dhe të pusetave në Njesinë Administrative nr. 1, nr. 2, nr. 3, Velabisht, Sinje, Otlak, Roshnik

- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të bardha në 830 zgara të vogla ekzistuese në Njesitë Admin. Nr. 1, nr. 2, nr. 3.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të larta në 30 zgara pritese të mëdha në të gjithë territorin e bashkisë
- Parashikohet të vendosen zgara pritese për ujrat e larta 50 cope në të gjithë territorin e Bashkisë.

1. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

- Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave, duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.
 - Vijezi i vijave të bardha të këmbësorëve me permasa 3 x 0.5 m, në total 1398 m² në rrugët: Rruga Antipatrea (Ura e Anit – Uznove e Madhe), Rruga Ura e Re, Shetitore Osumi, Rr. Santa Lucia.
 - Vijezi i vijave gjatësore trafik ndarëse me gjerësi 12 cm, në total 23400 m në rrugët: Rruga Antipatrea (Ura e Anit – Uznove e Madhe), Rruga Ura e Re, Shetitore Osumi, Rr. Santa Lucia
- **Realizimi i dekorit të Qytetit** dhe të qendrave të Njesive administrative sipas kalendarit të festave zyrtare.

EMERTIMI I PROGRAMI Transporti publik 04570

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat, shoqëria private e transportit.

Fondi planifikuar 1 482 000 leke ose 0.2% e totalit të shpenzimeve..

-shpenzime korrente 1 483 000 leke. (pagat + sigurimet e 2 specialisteve të Dr.Transportit)

-shpenzime kapitale -----

Nr. Punonjesve. 2 (specialist të Dr.Transportit)

• **Pershkrimi i programit:**

- Kontraktimi i shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal; (shoqëria private e transportit nuk merr subvencion nga Bashkia).



BASHKIA BERAT

- Mbikëqyrje dhe rregullim i shërbimeve të transportit publik lokal të shoqërive private (miratimi i tarifave për pasagjerët dhe i orëve dhe shpeshtësisë së shërbimeve etj.);
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, orareve etj. të operacioneve të sistemit publik lokal të transportit;

Nënfunkcioni 047: Industri të tjera

Nxitja e projekteve zhvillimore që kanë për qëllim rritjen ekonomike e turzimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, si dhe zhvillimin dhe promovimi i turizmit.

EMERTIMI I PROGRAMI PROJEKTE ZHVILLIMI 04740

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 3 841 000 leke. ose 0.4% e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente 3 841 000 leke.

-shpenzime kapitale _____

Nr. Punonjesve. 4

Pershkrimi programit:

- Ndërtim, mirëmbajtje, zgjerim, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatëse me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore.
Hartimi dhe monitorimi i projekteve që kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

EMERTIMI I PROGRAMIT : ZHVILLIMI I TURIZMIT 04760

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 2 552 000 leke. ose 0.3% e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente 2 552 000 leke.

-shpenzime kapitale _____

Nr. Punonjesve 3

Pershkrimi programit

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor.
- Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaurës promovuese e të një natyre të ngjashme;
Përmirësim i hapësirave pamore urbane të bashkisë, përmes mirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore.



BASHKIA BERAT

FUNKSIONI 5: MBROJTJA E MJEDISIT

Nënfunkcioni 051: Menaxhimi i mbetjeve

Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj.

EMERTIMI I PROGRAMIT Menaxhimi i mbetjeve 05100

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat & Sipermarrja e shërbimit të integruar të mbetjeve.

Fondi planifikuar 81 065 000 leke ose 8% e totalit të shpenzimeve.

-shpenzime korrente 68 049 000 leke.

-shpenzime kapitale 13 016 000 (lista e investimeve)

Nr. Punonjesve 3 (mbikqyreti e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve + ing.mjedisi)

Pershkrimi programit:

- Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;
- Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
- Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;

Pastrimi i rrugëve, parqeveve etj.

Objektivi strategjik: Sigurimi i menaxhimit gjithëpërfshirës dhe strategjik për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane nëpërmjet kryerjes së studimeve dhe projekteve për mbylljen dhe rehabilitimin e pikave të hedhjes së mbetjeve.

Programi i **menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane** parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet. Ky shërbim është shtrirë edhe në njesite administrative të bashkisë.

Objektivat

Bashkia Berat gjatë 5 vjeçarit 2019- 2024 të menaxhimit të mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim , duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për në landfill/ shesh depozitimi . Ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane , duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Në studimin që ka përgatitur Grupi I punës I Bashkisë nën asistencën dhe mbështetjen e eksperteve të DLDP dhe Helvetas Swiss Cooperation parashikohen objektiva emergjente dhe objektiva afat gjatë .



BASHKIA BERAT

Objektiva emergjente

- *Miratimi i planit lokal të Menaxhimit të integruar të Mbetjeve
- *Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve, duke përcaktuar standartet minimale që duhen plotësuar
- *Llogaritja e kostove sipas VKM Nr. 319, datë 31.05.2018 “ Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve “
- *Në Njave ku aktualisht ofrohet shërbimi, bashkia do të rrisë standartin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve

Objektiva afatgjata

* Konsolidimi i shërbimit në njësitë administrative (Berat, Sinje, Velabisht, Otlak, Roshnik) ku ofrohet shërbimi dhe zgjerimi i shërbimit në njësitë administrative (ku aktualisht nuk ofrohet shërbim (në masën 60%) gjatë periudhës 2017 – 2020.

- Në NJA-ve ku aktualisht ofrohet shërbimi, bashkia do të rrisë standartin e shërbimit duke përmirësuar infrastrukturën për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;

- * Reduktimi depozitimesh ilegale të mbetjeve urbane dhe sidomos të mbetjeve voluminoze.
- Promovimi i ndarjes në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Beratit;

- Shtrirja e skemës në dy rryma në lagje të tjera të qytetit, deri në mbulimin e plotë të tij;
- Promovimi i skemave të kompostimit të mbetjeve në NJA Roshnik, Sinje
- Shtrirja e skemave të kompostimit edhe në njësitë e tjera administrative me karakter rural.
- * Rritja e nivelit të të ardhurave nga tarifat nga njësitë, të cilat marrin shërbim me

- Informimi i qytetarëve në lidhje me shërbimet e pastrimit që do të mbulohen nga tarifa;
- Aplikimi i fushatave ndërgjegjëse në lidhje me pagesën e tarifës së pastrimit dhe rritjet progresive në sajë të përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve për mbetjet: dëgjesa publike në të gjithë territorin e bashkisë me grupe të ndryshme interesi.

- * Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, duke konsoliduar mekanizimin e hartimit të buxhetit për shërbimet e mbetjeve dhe hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave bazuar në standartet e paracaktuara në rregulloret përkatëse të shërbimit.

Produktet që synohen të ofrohen sipas preventivit të paraqitur në studimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.



BASHKIA BERAT

Pasqyra e dinamikës së shërbimeve publike vendore për periudhën 2016-2018

000/leke

Pershkrimi	Fakti 2016	Fakt 2017	Plani 2018
Pastrimi Qytet	53,103,	52,516,	54,496,
Pastrimi Fshat	9,304,	7,122,	7,122,
Mirembajtje e Varrezave	129,	3,258,	3,258,
Dekori	0	0	720
Mirembajtje e Lapidareve	0	0	28
Totali Shërbime Publike	62,537,	62,896,	65 625.

SITUATA AKTUALE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE

Shërbimi i largimit të mbetjeve të ngurta urbane për qendrën e qytetit të Beratit është i kontraktuar me kompaninë “Infinit Construction” afati i kësaj kontrate është 5 vjeçare, kjo kontratë ka filluar më 27.04.2014 deri 26.04.2019 me opsionin e rishikimit 1 herë /vit.

Kjo kontrata përmban:

- grumbullim transport mbeturina,
- fshirje rrugësh,
- larje rrugësh
- rinovim kontejnerësh 55 copë ne vit.

Të gjithë banorët marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane. dhe sasia e mbetjeve të gjeneruar (ton/dit) është 44.64 ton/dit të cilat përfundojnë në vend depozitimit të autorizuar i cili ndodhet 3 km larg nga qendra e qytetit.

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta në qytetin e Beratit nga kontejnerët kryhet me një frekuencë 6 herë në javë, duke evituar grumbullimin mbi normën e caktuar të mbetjeve në kontejnerët e qytetit.

Ndarja e mbetjeve në burim nuk aplikohet aktualisht në qytetin e Beratit.

Njesite Administrative Otllak, Velabisht, Sinje , Roshnik

Shërbimi i largimit të mbetjeve të ngurta urbane për 4 Njesite Administrative { Otllak , Velabisht, Sinje, Roshnik } është i kontraktuar me kompaninë “SAJMIRI GRUP” sh.p.k. ” afati i kësaj kontrate është 3 vjeçare, kjo kontratë ka filluar më 27.08.2016 deri 27.08.2019 me opsionin e rishikimit 1 herë /vit.

Kjo kontrata përmban:

- grumbullim transport mbeturina,
- fshirje rrugësh dhe trotuaresh me krahe ,
- blerje kontejnerësh 177copë ne vitin e pare.n



BASHKIA BERAT

Ne Njësine administrative **Otlak** është njësia e dytë administrative më e madhe pas qytetit të Beratit marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 14395 banore . dhe sasia e mbetjeve te gjeneruar (ton/dit) është 5659 kg /dit me nje frekuence sherbimi 4 here ne jave .(73%)

Ne Njësine administrative **Sinje** marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 2245 banore . dhe sasia e mbetjeve te gjeneruar është 499 kg /dit me nje frekuence sherbimi 2 here ne jave .(43%)

Ne Njësine administrative **Roshnik** ë marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 2543 banore . dhe sasia e mbetjeve te gjeneruar është 561 kg /dit me nje frekuence sherbimi 2 here ne jave .(30%)

Ne Njësine administrative **Velabisht** marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane 9239 banore . dhe sasia e mbetjeve te gjeneruar është 2069 kg /dit me nje frekuence sherbimi 2 here ne jave .(69%)

Këto mbetje aktualisht përfundojnë në një vend depozitim në fshatin Orizaj i cili ndodhet rreth 3-4 km larg nga qendra e qytetit , i cili ndodhet në rrjedhën e lumit Osum duke krijuar kështu një ndotje të larte mjedisore.

Në të gjithë bashkinë janë 6 kamionë me kompaktin ku 4 prej tyre operojnë në qendrën e qytetit dhe dy në njësitë administrative Otlak, Roshnik, Velabisht dhe Sinje . Secila prej këtyre njësive disponon dhe nga një kamion të hapur për mbledhjen e mbetjeve të cilat nuk janë të hedhura neper kontejnerë, por gjithashtu këta kamionë shërbejnë dhe për mbledhjen e mbetjeve të ndryshme inerte të cilat depozitohen në territorin e kësaj bashkie.

ASPEKTE FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Kostoja e plote e manaxhimit te sistemit te mbetjeve per vitin 2016-2018

Vitet	Buxheti vjetor I bashkise	Buxheti sherbimeve publike	Buxheti per menaxhimin e mbetjeve	% e buxhetit te mbetjeve /buxhetit te sherbimeve publike	000/lek % e buxhetit te mbetjeve /buxhetit total te bashkise
Fakti 2016	798,440	170,857	62,407	37	8
Fakti 2017	938,845	167,840	61,618	37	7
Plani 2018	1,010,163	188,217	61,618	33	6



BASHKIA BERAT

Planifikimi i fondeve per menaxhimin e mbetjeve te ngurta urbane per periudhen 2019-2023

Ne 000
leke

Nr.	Pershkrimi	V.2,019	V.2,020	V.2,021	V.2,022	V.2,023
1	Shpenzime Operative	65,190	67,653	67,653	67,653	67,653
2	Investime (Blerje Kontenieresh)	8,400	4,200	2,520	2,520	2,436
Totali		73,590	71,853	70,173	70,173	70,089

Shpjegim: Planifikimi eshte mbeshtetur:

Per periudhen 01.12.2017 - 27.04.2018 sipas kontratave te lidhura 25,162 mije leke
Per periudhen 28.04.2018 - 30.11.2018 planifikimi sipas studimit te paraqitur ne zbatim te VKM
Nr. 319 date 31.05.2018 planifikojme 40 028 000 leke nga te cilat 8 400 000 blerje
kontenieresh dhe 31 628 000 leke shpenzime korrente.

Nënfunkcioni 052: Menaxhimi i ujërave të zeza

Veshtrim i pergjithshem : Funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza. Ndërtimi dhe menaxhimi i sistemit të kolektorëve, kanaleve, tubacioneve dhe pompave për të larguar të gjitha ujërat e zeza (ujin e shiut, ujërat shtëpiakë dhe ujëra të tjerë të ndotur).

EMERTIMI I PROGRAMIT Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve 05200

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 8 832 000 leke. ose 1% e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente -----

-shpenzime kapitale 8 832 000 leke (lista e investimeve)

Nr. Punonjesve

Pershkrimi programit:

- Administrim, mbikëqyrje, inspektim, vënie në funksionim ose mbështetje e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza;
 - Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të zeza.
 - **Objektivi strategjik:**

Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, nëpërmjet arritjes së mbulimit të rrjetit të kanalizimit në zonat urbane dhe në zonat rurale dhe rritjes numrit të familjeve të lidhur me trajtimin e ujërave të zeza



BASHKIA BERAT

FUNKSIONI 6: STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

Nënfunkcioni 061: Urbanistika

EMERTIMI I PROGRAMIT PLANIFIKIMI URBAN VENDOR 06140

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 11 049 000 leke. 1.1% e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente 11 049 000 leke

-shpenzime kapitale ----- leke

Nr. Punonjesve. 12

- **Pershkrimi programit:** Zhvillim, përditësim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të zhvillimit urbanistik;
- Planifikim, administrim, zhvillim dhe kontrolli i territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Grante, hua ose financime për të mbështetur zgjerimin, përmirësimin ose mirëmbajtjen e stokut të banesave;
- Lëshimi i lejeve për ndërtime të reja; zhvillimi i tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
- Administrim, bashkërendim dhe monitorim i planeve të përgjithshme, planeve, programeve dhe buxheteve të lidhura me strehimin;
- Shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e strehimit;
- Sigurimi i truallit të nevojshëm për ndërtime banesash; ndërtim ose blerje dhe rimodelim i njësive banuese për publikun në përgjithësi ose për njerëz me nevoja të posaçme; eliminim i ndërtimeve të degraduara i lidhur me sigurimin e strehimit.
- Planifikim i përgjithshëm duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin, të Planeve të Përgjithshme Vendore /Planeve të Zhvillimit Strategjik; Hartimi i planeve të zonimit dhe i rregullave të ndërtimit

EMERTIMI I PROGRAMIT Shërbimet publike vendore 6260 Gjelberimi:

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat dhe Ndermarrja e Gjelberimit .

Fondi planifikuar 53 145 000 leke, 5.2 % e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente 43 640 000 leke

-shpenzime kapitale 9 505 000 leke (Sipas listes se investimeve)

Nr. Punonjesve. 58 Ndermarrja +1 Bashkia

Objektivi strategjik: Rritja e cilësisë së shërbimeve publike në territorin e qeverisjes vendore



BASHKIA BERAT

- **Pershkrimi programit** Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin;
- Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapsirën e gjelbërt të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.
- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.

Objektivat e Programit

- Mirembajtjen e struktureve të sipërfaqeve të gjelbërta duke kryer të gjitha proceset teknologjike të punës për mirembajtjen e sipërfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure të gjelbra.
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta duke shtuar mbjelljet me lule sezonale, sipërfaqe me bar, mbjellja e pemëve dekorative etj.
- Mirembajtja e tendave dhe e pjergullave.
- Mirembajtja e qoshkave dekorative, tavolinave dhe stolave në të gjitha sipërfaqet e gjelbërta.

Produktet që synohen të ofrohen

- Kryerjen e të gjitha proceseve teknologjike të punës si punim toke, vaditje, prashitje, krahsitje, plehrim, pastrim, grumbullim mbeturinash etj. në një sipërfaqe të gjelbre prej **93.203 m²** ku nga kjo 16.804 m² është sipërfaqe rruge e sheshe, 70.336 m² është sipërfaqe bar (tapete), 4.821 m² sipërfaqe lule.
- Mirembajtja e **467** stolave për të ofruar gjithmone vende shplodhjeje për qytetarët dhe mirembajtjen e vepra arti 24 cope.
- Mirëmbajtje e gjithë inventarit të përfshirë në sipërfaqet e gjelbërta si, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicues, cezma zbukuruese, kende lojrash për fëmijë, e kende argëtuese për moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.
- Mbjellja e **320 rrenje druresh të rinj, 400 shkurreve** në rrugë e lulishte dhe mbjellja me lule sipas sezoneve në **4821 m² sipërfaqe lulësh**, në lulishtet e qytetit, duke synuar të kthejmë traditën.
- Mirembajtjen e Drure Dekorative gjithsej 4.110 rrenje nga të cilat 1.700 janë në parqe dhe lulishte, kurse 2.410 rrenje janë drure dekorative në rrugë, të cilat janë gjithsej 15 lloje.



BASHKIA BERAT

Nënfunkcioni 063: Furnizimi me ujë 06330

EMERTIMI I PROGRAMIT Furnizimi me ujë 06330

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat .

Fondi planifikuar 32 067 000 leke. ose 3.1% e totalit te shpenzimeve.

-shpenzime korrente ----- leke

-shpenzime kapitale 32 067 000 leke e investimeve e investimeve

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, nëpërmjet arritjes me mbulim të rrjetit të furnizimit me ujë në zonat urbane dhe mbulim të rrjetit të ujësjiellësit në zonat rurale

- Administrim i problemeve të furnizimit me ujë;
- Mbikëqyrje dhe disiplinim i të gjitha problemeve të furnizimit me ujë, duke përfshirë pastërtinë e ujit, çmimin dhe kontrollet e sasisë;
- Ngritja ose vënia në funksionim e kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë;
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet e furnizimit me ujë;

Nënfunkcioni 064: Ndriçimi i rrugëve

EMERTIMI I PROGRAMIT Ndriçim rrugësh 06440

Njesia shpenzuese: Bashkia Berat , Ndermarja e Shërbimeve Publike

Fondi planifikuar 24,333 000 leke ose 2.5% e totalit te shpenzimeve..

-shpenzime korrente 24 333 000 leke

-shpenzime kapitale ----- leke

Nr. Punonjesve. 4

Perskrimi programit: Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike;

